

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5814  
E shtunë, 29 qershor 2019  
çmimi 0.40 €

Zgjedhen pesë  
anëtarët e Këshillit  
Drejtues të UP-së **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURATI **FAQE 4-5**

## Vetëm ShBA-ja mund ta zhblllokojë dialogun Kosovë - Serbi

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka mirëpritur vendimin e Gjykatës Kushtetuese për ta shpallur jokushtetues ekipin negociator të Kosovës për bisedime me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky subjekt

politik që nga fillimi e ka konsideruar absurd hartimin e një ligji për negociatat dhe ekipin negociator. Murati ka thënë se tani pozita dhe opozita duhet të ulen bashkërisht në një tryezë politike për të arritur një konsensus për bisedimet. Sipas tij, vetëm ShBA-ja

mund ta zhblllokojë dialogun Kosovë - Serbi. Murati ka folur edhe për mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme, duke theksuar se zgjedhjet pa një reformë zgjedhore nuk do të prodhojnë institucione më cilësore dhe më demokratike

## Kosnetti kërkon nga policia luftimin e korrupsionit **FAQE 3**



Përveç mbledhjes së nënshkrimeve të opozitës për rrëzimin e qeverisë, edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese, se delegacioni shtetëror është antikushtetues, ka shtuar gjasat që këtë vit të organizo-

hen zgjedhje të parakohshme. Madje, sipas përfaqësuesve të partive opozitare, pas zhvillimeve të fundit në skenën politike zgjedhjet e parakohshme pritet të mbahen në vjeshtë




## Debati për homologimin e automjeteve përfundon pa asnjë vendim **FAQE 9**

**FAQE 9**

### OPINION

#### ZGJEDHJET, PROTESTAT DHE DEKRETET **F. 11**

Rexhep QOSJA



### AKTUALE

#### THAÇI: BASHKIMI I LUGINËS, ËNDËRR E ÇDO SHOQIPTARI **F. 5**

#### KOMF-I BËN THIRRJE PËR MOBILIZIM PAS MIRATIMIT TË LIGJIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE **F. 6**



### EKONOMI

#### ZGJATET DERI MË 12 KORRIK AFATI PËR APLIKIM PËR PAGESA DIREKTE DHE GRANTE INVESTIVE **F. 9**

#### LLUKA: NGA 14 PRILLI 2020 KOSOVA DO T'I KONTROLLOJË KUFIJTË E VET ENERGJETIKË **F. 9**

### KULTURË

#### VAJI I BURRIT DREJT FUNDIT TË BOTËS **F. 14**

Berat ARMAGEDONI

### SPORT

#### 120 LICENCA PËR TRAJNERË TË FUTBOLLIT **F. 16**

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Zgjedhjet e 30 qershorit në Shqipëri të zhvillohen qetë

Derisa presidenti i Shqipërisë Ilir Meta ka bërë të ditur se ka dekretuar 13 tetorin si ditë kur qytetarët e Shqipërisë do të votojnë për kryebashkiakët e tyre, Edi Rama ka reaguar menjëherë, duke e quajtur "çmenduri" vendimin e presidentit dhe ripërsëriti se data e vetme e zgjedhjeve në Shqipëri është 30 qershori



**TIRANË, 28 QERSHOR** - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë u bëri thirrje të gjithë udhëheqësve politikë, zyrtarëve të qeverisë, agjencive të sigurisë dhe qytetarëve shqiptarë që të sigurohen që zgjedhjet e 30 qershorit të zhvillohen në mënyrë të qetë dhe transparente.

"Ne nxisim udhëheqësit politikë të refuzojnë çdo dhe të gjitha llojet e dhunës, apo çdo përpjekje për të penguar procesin zgjedhor apo edhe të drejtën e çdo qytetari për të votuar. Dhuna nuk është një mënyrë legjitime e të shprehurit politik", thuhet në deklaratën e Ambasadës amerikane.

Sipas saj, ata që përfshihen në akte dhune duhen hetuar me të gjithë fuqinë e ligjit.

Në deklaratë bëhet e ditur se Shtetet e Bashkuara do të kenë ekupe vëzhguesish në qendrat e votimit dhe qendrat e numërimit në mbarë Shqipërinë.

Ambasada amerikane po ashtu u bëri thirrje udhëheqësve politikë të Shqipërisë që, pas zgjedhjeve të së dielës, të rikthejnë vëmendjen e tyre në forcimin e institucioneve demokratike shqiptare dhe zbatimin e ligjit. Shqipëria, tash e sa kohë, është përfshirë nga një krizë politike. Opozita, me muaj, proteston kundër qeverisë së udhëhequr nga kryeministri Edi Rama dhe është zotuar se do t'i bojkotojë zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Të enjten, presidenti i

Shqipërisë, Ilir Meta, i cili i ka anuluar zgjedhjet më 30 qershor, ka dekretuar 13 tetorin si datë të re të mbajtjes së zgjedhjeve.

Megjithatë, Partia Socialiste në pushtet, e udhëhequr nga kryeministri Rama, insiston në 30 qershor.

Data e fundit njihet si datë zyrtare e zgjedhjeve edhe nga bashkësia ndërkombëtare dhe ambasadat me seli në Tiranë.

Edhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë dhe drejtuesit më të lartë të OSBE-së bënë të premtën thirrje për të shmangur dhunën dhe për të garantuar një proces të qetë në zgjedhjet vendore të së dielës, duke rikonfirmuar në këtë mënyrë njohjen prej tyre zyrtarisht të kësaj date, si ditë për mbajtjen e zgjedhjeve.

Bashkimi Evropian dënoi të premtën dhunën e çdo forme dhe deklaroi se qytetarët shqiptarë duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar në mënyrë të rregullt dhe paqësore në votimet e 30 qershorit. "Është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e të gjithë aktorëve politikë për të siguruar që veprimtaritë e votimit të mos pengohen", theksoi BE-ja në deklaratën e publikuar të premtën.

BE-ja kujtoi se demonstrata e 21 qershorit në Tiranë ishte e paqësore dhe të njëjtat parime dhe vlera demokratike duhen ruajtur këtë fundjavë. "Çdo veprim i dhunshëm apo çdo formë nxitjeje për dhunë janë

absolutisht të papranueshme në çfarëdo lloj rrethane. Të gjitha palët politike duhet të tregojnë përmbajtje dhe të shmangin retorikën provokuese", deklaroi BE-ja, duke shtuar se "procesi i votimit do të vëzhgohet nga një mision ndërkombëtar i drejtuar nga OSBE/ODIHR që përfshin vëzhgues nga disa vende anëtare të Bashkimit Evropian". Kryetari i radhës i OSBE-së dhe ministri i Jashtëm dhe për Çështjet Evropiane i Sllovakisë, Miroslav Lajčak, sekretari i përgjithshëm i OSBE-së, Thomas Greminger, presidenti i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, George Tsereteli dhe sekretari i përgjithshëm i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, Roberto Montella,

publikuan një deklaratë të përbashkët, ku nxitin sërish të gjithë aktorët politikë të angazhohen në politika konstruktive, të respektojnë proceset demokratike të vendit dhe të tregojnë vetëpërmbajtje. Por presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, publikoi një mesazh drejtuar qytetarëve, ku thekson se data kushtetuese për zgjedhjet vendore është 13 tetori. "Situata është e qartë dhe e padiskutueshme nga ana ligjore dhe kushtetuese. Por kryeministri insiston për të shkruar në votime socialiste në datën 30 qershor, ku ata vetë do votojnë, vetë do t'i numërojnë", tha ai. Meta shtoi se të gjithë shqiptarët së bashku, në mënyrë demokratike, të fshehtë, të lirë dhe të ndershme do të zgjedhin

vetëm në 13 tetor 2019. "Ju këshilloj ta merrni atë me qetësi dhe mençuri, dhe të mos bini pre e provokimeve, sepse ato iu shërbejnë vetëm atyre që duan të legjitimojnë kapjen totale të shtetit dhe instalimin e një regjimi njëpartiak", tha Meta. Ai kërkoi të respektohen dhe të mos ketë konfrontime me ata bashkëqytetarë që do të shkojnë në këto "votime socialiste". "Konfrontimi dhe dhuna nuk i shërben Shqipërisë dhe së ardhmes së saj evropiane, dhe sidomos bashkëjetesës sonë qytetare në çdo familje, në çdo lagje, në çdo fshat, në çdo komunitet dhe në të gjithë shoqërinë tonë. Mos u nervozoni nga provokimet që do t'ju bëhen për t'ju çuar drejt dhunës", tha Meta.

## Ushtria gjermane vazhdon edhe një vit mandatin në Kosovë

Berlin, 28 qershor - Parlamenti i Gjermanisë miratoi të premtën vazhdimin edhe për një vit të misioneve ushtarake në Kosovë dhe në Liban.

Kontingjenti gjerman në Kosovë është zvogëluar me vite dhe, aktualisht, vetëm 70 ushtarë gjermanë shërbejnë në misionin paqeruajtës të NATO-s, KFOR. Në Liban, ndërkaq, Gjermania

ka një personel prej 140 ushtarësh.

Ata janë të përfshirë në patrullimet në det dhe në stërvitjen e Marinës së Libanit.

Partia e ekstremit të djathtë, Alternativa për Gjermaninë, e kundërshtoi zgjatjen e misioneve ushtarake edhe në Kosovë, edhe në Liban, por, megjithatë, ato u miratuan nga shumica.



Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, ka marrë pjesë në ceremoninë e diplomimit të Shkollës së Stafit dhe Komandës së Policisë (SPSC)

## Kosnetti kërkon nga policia luftimin e korrupsionit

Korrupsioni është problem i madh në institucionet e Kosovës, por shpresoj se policët do ta luftojnë atë. Kështu ka deklaruar të premten ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, në ceremoninë e diplomimit të Shkollës së Stafit dhe Komandës së Policisë (SPSC). Ai ka thënë se policët duhet ta japin shembullin e ndershmërisë duke luftuar korrupsionin. Sipas Kosnettit, lufta kundër korrupsionit është mjaft e vështirë dhe e rrezikshme, por mund të ketë sukses

EPOKA  
ERE

Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 28 QERSHOR** - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë të premten se korrupsioni është problem i madh në institucionet e Kosovës, por shpreson se policët do ta luftojnë atë. Këto komente ambasadori amerikan i ka bërë në ceremoninë e diplomimit të Shkollës së Stafit dhe

Komandës së Policisë (SPSC), për të diplomuarit e së cilës tha se tashmë janë të gatshëm për përgjegjësi më të mëdha.

Para të pranishmëve ambasadori amerikan ka deklaruar se lufta kundër korrupsionit është mjaft e vështirë dhe e rrezikshme, por mund të ketë sukses. Sipas diplomatit Kosnett, policët e Kosovës duhet ta japin shembullin e ndershmërisë duke luftuar korrupsionin. "Nuk është fshehtësi se korrupsioni është problem i madh në



institucionet e Kosovës dhe si prijës në polici do të sfidoheni që ta rezistoni dhe kundërshtoni korrupsionin në shumë nivele. Si prijës të lartë ju dhe kolegët tuaj duhet ta jepni shembullin e ndershmërisë dhe integritetit për çdo ditë. Luftimi i korrupsionit është i vështirë e, nganjëherë, është edhe punë e rrezikshme, por sukcesi mund të arrihet", është shprehur Kosnetti. Ambasadori amerikan ka theksuar se shumë të diplomuar të SPSC-së tashmë shërbejnë në pozita të larta të udhëheqjes në agjenci të zbatimit të ligjit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe në Kosovë. "Përgatitjet dhe kualifikimet e juaja nga ky shkollim tregojnë se tashmë jeni të gatshëm për të marrë përgjegjësi të mëdha dhe së shpejti do ta praktikoni përvojën dhe trajnimin në nivelin më të lartë të udhëheqjes", ka deklaruar diplo-

mat Kosnett.

Gary Bulard i cili ka trajnuar disa gjenerata nga kjo shkollë, këtë diplomim e ka konsideruar shumë të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të liderit të Kosovës. "Ky trajnim është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e vazhdueshëm të liderit të Kosovës, duke mësuar shkathhtësitë e njohuritë që do t'ju përgatisin kapacitetet tuaja të tashme dhe të ardhme. Siç e ceku edhe ambasadori, shumë të diplomuar janë zyrtarë të lartë në Amerikë dhe në Kosovë", ka theksuar Bulardi. Në këtë ceremoni diplomimi, përveç zyrtarëve amerikanë, kanë marrë pjesë edhe ministri i Brendshëm i Kosovës, Ekrem Mustafa, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj dhe zyrtarë të tjerë nga organet e sigurisë dhe drejtësisë në vend.

## Haradinaj dhe Idrizi shprehin përkushtimin për thellim të bashkëpunimit Kosovë -Shqipëri

**PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të premten ka pritur në takim kryetarin e Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU), Shpëtim Idrizi nga Shqipëria, me të cilin ka biseduar për zhvillimet mbarëkombëtare politike dhe për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve.


Kryeministri Haradinaj e ka njoftuar kryetarin Idrizi për prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, veçmas në zhvillimin ekonomik, proceset euroatlantike dhe bashkëpunimin ndërfaqinësor si

një parakusht për integrim të vendeve të Ballkanit Perëndimor në familjen evropiane.

Duke e falënderuar për përkrahjen e vazhdueshme që shteti shqiptar ka dhënë për Kosovën në çastet më të vështira, kryeministri Haradinaj ka thënë se edhe tani është i domosdoshëm bashkëpunimi politik institucional për rrugën euroatlantike të dy vendeve. "Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) në vazhdimësi ka synuar promovimin e çështjes shqiptare si parti e kauzave kombëtare dhe mbrojtjes së diasporës. Bashkëpunimi ndërmjet spektrit politik të

Kosovës me atë të Shqipërisë në të gjitha periudhat ka qenë i frytshëm dhe uroj që një rrugëtim i tillë të na përcjellë çdoherë", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Ndërsa kryetari i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU), Shpëtim Idrizi, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për pritje si dhe ka shprehur gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit Shqipëri - Kosovë. Në këtë takim kryetari i PDIU-së, Shpëtim Idrizi, ka qenë i shoqëruar nga anëtarët e kryesisë së partisë, Galip Taho dhe Aqif Rakipi.



Flet për "Epokën e re", Valon Murati

# Vetëm ShBA-ja mund ta zhbllo



Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka mirëpritur vendimin e Gjykatës Kushtetuese për ta shpallur jokushtetues ekipin negociator të Kosovës për bisedime me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky subjekt politik që nga fillimi e ka konsideruar absurd hartimin e një ligji për negociatat dhe ekipin negociator. Murati ka thënë se tani pozita dhe opozita duhet të ulen bashkërisht në një tryezë politike për të arritur një konsensus për bisedimet. Sipas tij, vetëm ShBA-ja mund ta zhbllojë dialogun Kosovë - Serbi. Murati ka folur edhe për mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme, duke theksuar se zgjedhjet pa një reformë zgjedhore nuk do të prodhojnë institucione më cilësore dhe më demokratike

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 QERSHOR - "Epoka e re": Z. Murati, Gjykata Kushtetuese e ka shpallur ekipin negociator jokushtetues. Si e keni parë këtë vendim të

Kushtetueses?

**Murati:** Në radhë të parë ne si Lëvizje për Bashkim e kemi kritikuar që në fillim qasjen për formimin e ekipit negociator si dhe rezolutën e Kuvendit të Kosovës për bisedimet. Që nga fillimi e kemi konsideruar

absurd hartimin e një ligji për negociatat dhe për ekipin negociator. Kosova i ka institucionet e ligjshme dhe ekipi negociator ka mundur të jetë prodhim i një marrëveshjeje politike në mes të partive politike të pozitës dhe të opozitës, e cila do ta hartonte një

platformë politike unike për bisedimet me Serbinë dhe do të punonte në bazë të asaj platforme. Hartimi i ligjit, dhe dhënia e një sërë kompetencash delegacionit shtetëror për bisedime, ashtu siç ka konstatuar Gjykata Kushtetuese, ka cenuar punën e institucioneve kushtetuese të vendit, përkatësisht qeverisë dhe presidentit. Por, megjithatë, më duhet të theksoj se problemet themelore në raport me qasjen e partive tona me bisedimet nuk janë kushtetuese dhe ligjore, por politike. Ato në vend se të punojnë ngushtë për arritjen e një konsensusi politik për dialogun, po punojnë që të minojnë çfarëdo mundësie për bashkëpunim si dhe nga ky minim i bashkëpunimit dhe i bisedimeve

të përfitojnë politikisht në planin afatshkurtër. Problemet janë politike sepse edhe problemet me Serbinë duhet të zgjidhen politikisht, pa kufizimet kushtetuese. Për më tepër, për shkak të kufizimeve të mëdha e që Kushtetuta jonë përmban në raport me funksionalizimin e shtetit tonë, këto bisedime do të duhej të prodhonin edhe ndryshimin e Kushtetutës. Problemet janë politike sepse kësaj radhe nuk duhet folur vetëm për Kosovën dhe serbët, por edhe për Serbinë dhe shqiptarët që jetojnë nën sundimin serb.

"Epoka e re": PSD-ja si sponsorizuese e Ligjit për dialogun me Serbinë thotë se Kushtetuesja e ka rikthyer këtë proces në duart e

# Bllokojë dialogun Kosovë - Serbi

presidenti, as kryeministri, por as ndonjë grup negociator nuk e ka tagrin e imponimit të ndonjë marrëveshjeje e cila kundërsh-tohet nga Kuvendi i Kosovës. Këto institucione mund ta negociojnë marrëveshjen, por jo edhe ta imponojnë. Ndërsa fakti që ne flasim për divergjenca kompetencash në nivele institucionale dëshmon për faktin se sa të papjekur e kemi klasën politike e cila e ka të pamundur që në këto çaste historike të bëhet bashkë për bisedimet me Serbinë.

**"Epoka e re":** Si duhet të veprojnë pozita dhe opozita pas këtij vendimi të Kushtetueses?

**Murati:** Pozita dhe opozita duhet të ulen bashkërisht në një tryezë politike për të arritur një konsensus për bisedimet. Ato duhet ta lënë mënjanë përpjekjen që çdo gjë ta shohin nën prizmin e përfitimeve elektorale dhe të kuptojnë se në çfarë momenti historik po kalojmë.

**"Epoka e re":** Pasi dështoi mbajtja e takimit të Parisit, i cili dukej si përpjekje për ta zhbllokuar dialogun Kosovë - Serbi, nuk dihet se kur mund të vazhdojë. Si e shihni zhbllokimin e këtij procesi?

**Murati:** Samiti i Berlinit dhe ai i Parisit janë menduar të ndihmojnë në ringjalljen e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ishte kjo një përpjekje e Gjermanisë dhe Francës për ta fuqizuar rolin e tyre në këtë proces dhe në Ballkan në përgjithësi. Por, në anën tjetër, ideja e dështimit të Samitit të Parisit është shtruar që në Samitin e Berlinit. Gjermania dhe Franca as në Berlin e as ndërkohë gjatë përgatitjes së Samitit të Parisit nuk arritën t'i bindin palët të tërhiqen nga pozicionet e tyre (Kosovën për taksën e Serbinë që të kthehet në bisedime pa marrë parasysh vendosjen e taksës nga Kosova). Gjithashtu, të dy shtetet kryesore evropiane nuk është se kishin dhe se kanë qëndrime unike rreth opsioneve për arritjen e një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë. Gjermania, duke qenë kundër ndryshimit të kufijve, asnjëherë nuk pati guxim publik të dalë me opsionin e vet, i cili përfliet se lëviz në mes të një asociacioni me përgjegjësi ekzekutive e deri tek autonomia politiko-territoriale për veriun e Kosovës. Në anën tjetër, Franca konsideron se të gjitha temat në mes të palëve duhet të jenë në tavolinë. Divergjencat franko-gjermane për këtë temë, ashtu si edhe për tema të tjera që lidhen me funksionimin e BE-së dhe institucioneve të saj, e kanë

pasur rolin e tyre në dështimin e takimit të Parisit. Gjithashtu, duhet theksuar edhe fakti se ShBA-ja nuk ishte pjesë e këtyre përpjekjeve për t'i ngjallur bisedimet, prandaj ka bërë që palët të jenë hezituese mbi suksesin e samitit dhe rrjedhimisht edhe të punojnë, ndoshta, në mënyrë indirekte që ai edhe të dështojë. Besoj se zhbllokimi i procesit të dialogut do të ndodhë me përfshirjen më të madhe të ShBA-së, që është e vetmja fuqi botërore që mund të garantojë implementimin e një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kjo përfshirje duhet të shfrytëzohet për zgjidhjen e problemeve me Serbinë dhe përmes modelit me të cilin më së shumti fiton populli shqiptar dhe Kosova e ai është ripërcaktimi i kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ky ripërcaktim do të duhej të nënkuptonte të drejtën e Kosovës Lindore, përkatësisht të pjesës shqiptare të Preshevës, Bujanocit e Medvegjës për t'iu bashkuar Kosovës si dhe Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit (pa shtatë fshatrat shqiptare) për t'iu bashkëngjitur Serbisë. Kjo do të duhej domosdo ta nënkuptonte ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës dhe

heqjen e privilegjeve bllokuese për pakicën serbe, njëkohësisht vazhdimin e mbrojtjes së pakicave përfshirë serbët përmes aplikimit të standardeve më të larta për të drejtat e njeriut dhe pakicave. Dy variantet e tjera që mund të jenë prodhim i këtij dialogu, sidomos nëse ne vazhdojmë të jemi të përçarë, refuzues e jo bashkëpunues, janë shumë të rënda për Kosovën, njëra më e keqe se tjetra. Dhe ato janë mbajtja e status quos aktuale e cila do ta bllokojë përparimin e shtetit të Kosovës qoftë në planin e zhvillimeve të brendshme, qoftë në planin e integritetit në institucionet kryesore ndërkombëtare si OKB, NATO, BE, por edhe në Këshillin e Evropës e të OSBE-së. Dhe e dyta, nëse marrëveshja krijon asociacionin me përgjegjësi ekzekutive për komunat serbe ose autonominë politiko-territoriale për veriun e vendit, do t'i shkaktonte goditje të rëndë funksionalitetit edhe ashtu problematik të Kosovës. Një marrëveshje e tillë do ta shtrojë rrugën për ndarjen e vendit në të ardhmen deri te lumi Ibër, pa arritur që Kosova Lindore të jetë pjesë e një marrëveshjeje që do të nënkuptonte

lëvizjen e kufirit. Është naive të mendohet se ne përfitojmë nga kjo situatë e bllokimit të dialogut. Për më tepër, ne mund të jemi humbës të mëdhenj nëse refuzojmë bisedimet apo i pengojmë ato. Ne duhet të punojmë fort për t'u marrë vesh në mes vete, me aleatët tanë dhe t'i shfrytëzojmë rrethanat aktuale ndërkombëtare për të arritur një marrëveshje me Serbinë e cila e zhbllokon Kosovën dhe e trajton përfundimisht njëherë e mirë çështjen e shqiptarëve në Kosovën Lindore.

**"Epoka e re":** Nga shumëkush përmenden zgjedhjet e reja si alternativë. A janë zgjidhje, zgjedhjet?

**Murati:** Kjo për të cilën po flasim, bisedimet pra, nuk janë të lidhura me zgjedhjet. Çfarëdo qeverie që do të kemi do të duhet të punojë ngushtë me opozitën për të kryer këtë proces të rëndësishëm për Kosovën. Për më tepër, vazhdoj të insistoj se zgjedhjet pa një reformë zgjedhore nuk do të prodhojnë institucionet më cilësore dhe më demokratike. Mund të ndërrohen individët, por jo edhe mendësia qeverisëse dhe raporti ndaj publikes.



## Thaçi takon ish-udhëheqësit e UÇPMB-së: Bashkimi i Luginës, ëndërr e çdo shqiptari

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të premten në takim disa prej ish-udhëheqësve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (UÇPMB). Ai ka thënë se

është duke punuar për ta bashkuar Luginën e Preshevës me Republikën e Kosovës. Sipas Thaçit, kjo është ëndërr e çdo shqiptari që jeton në luginë. "Një takim miqësor me disa prej ish-udhëheqësve të luftës së UÇPMB-së. Bashkimi i

Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Republikën e Kosovës është ëndërr e çdo shqiptari që jeton atje. Këtë ëndërr të tyre, pandalshëm, me vullnet politik, punoj që ta bëj realitet", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

presidentit, ndërsa dy subjektet e tjera opozitare deklarojnë se Kushtetuesja ka bërë me dije se kryeministri duhet të jetë bartës i këtij proces. Kush mendoni se ka të drejtë?

**Murati:** Ka qenë absurde që nga fillimi përpjekja për t'i kufizuar me ligj përgjegjësitë e presidentit dhe të kryeministrit e qeverisë në procesin e dialogut me Serbinë. Në fund të fundit, çfarëdo marrëveshjeje që mund të negociohet nga kushdo që përfaqëson Kosovën nuk mund të miratohet pa votën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Gjykata Kushtetuese ka qenë e qartë se politika e jashtme e Kosovës zbatohet në bashkëpunim në mes të qeverisë dhe presidentit. Dhe atë që e theksova më lart, askush, as

# KOMF-i bën thirrje për mobilizim pas miratimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve

Përfaqësues të koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF - kanë rekomanduar krijimin dhe aplikimin sa më parë të grantit specifik për shërbime sociale, i cili në aspektin buxhetor do ta mbështesë edhe procesin e implementimit efikas të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 28 QERSHOR** - Përfaqësues të koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF - kanë mbajtur një konferencë për media pas miratimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve. KOMF-i bashkë me organizatat anëtare si pjesë e grupit punues për hartimin e Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve përgjatë pesë vjetëve ka përfaqësuar organizatat për mbrojtjen e fëmijëve dhe ka ofruar ekspertizën dhe mbështetjen e nevojshme me qëllim të hartimit të një ligji të avancuar që mbron interesin dhe të drejtat e fëmijëve. Pas finalizimit të projektligjit, KOMF-i në vazhdimësi ka apeluar drejt kuvendit për miratimin e tij. Dy ditë pas konferencës së jashtëzakonshme për media të KOMF të mbajtur para dyerve të Kuvendit, Kuvendi i Kosovës miratoi Projektligjin për

Mbrojtjen e Fëmijëve. Të premtën, përmes konferencës për media, KOMF-i ka ofruar rekomandimet dhe veprimet që duhen ndërmarrë për implementimin efikas të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve pas hyrjes në fuqi. Përfaqësuesit e KOMF-it kanë njoftuar se në të njëjtën kohë është duke punuar për hartimin e formulës së financimit të shërbimeve sociale dhe krijimit të grantit specifik për shërbime sociale në mënyrë që të sigurohet minimumi i financimit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve. KOMF-i si pjesë e grupit punues për hartimin e formulës së financimit siguroi që do ta ofrojë mbështetjen e nevojshme për t'i paraqitur nevojat reale dhe për ta ndarë buxhetin e adekuat për fëmijët. KOMF-i ka rekomanduar krijimin dhe aplikimin sa më parë të grantit specifik për shërbime sociale i cili në aspektin buxhetor do ta mbështesë edhe



procesin e implementimit efikas të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve. Përfaqësuesit e KOMF-it kanë rekomanduar që komunat t'i hartojnë rregulloret dhe strategjitë komunale për të drejtat e fëmijëve në mënyrë që të jenë në linjë me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe t'i funksionalizojnë mekanizmat koordinues komunalë të parapara në Ligjin për

Mbrojtjen e Fëmijëve. KOMF-i ka mbështetur procesin e hartimit të rregullores dhe strategjive për të drejtat e fëmijëve në shtatë komuna, duke u ofruar model referues të gjitha komunave të Kosovës, një mundësi të replikimit të procesit dhe hartimit të Rregullores Komunale dhe Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve brenda komunave të tyre. KOMF-i ka shprehur gatishmërinë për

mbështetjen në hartimin e akteve nënligjore të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve. KOMF-i do ta monitorojë procesin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve pas hyrjes në fuqi përmes Indeksit për Mbrojtjen e Fëmijës. Projektligji për Mbrojtjen e Fëmijëve është aprovuar më 27 qershor nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 76 vota për dhe asnjë kundër.

## GAP-i: Procesi aktual i buxhetimit vë në rrezik pavarësinë e gjyqësorit dhe prokurorisë

**EPOKA E RE** Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 28 QERSHOR** - Instituti GAP të premtën ka publikuar raportin me temë "Nuk ka para për sundim të ligjit: si ndikon procesi buxhetor në pavarësinë e gjyqësorit?" Duke analizuar procesin e buxhetimit për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës studimi synon të nxjerrë në pah nëse qeveria mund të ndërhyjë në autonominë e tyre përmes mjeteve buxhetore. Ky raport argumenton se procesi aktual i buxhetimit mund ta vë në rrezik pavarësinë dhe efektivitetin e institucioneve gjyqësore dhe prokuroriale. "Disa nga



problemet e identifikuar në procesin e ndarjeve buxhetore përfshijnë mungesën e kohës dhe resurseve profesionale të Kuvendit të Kosovës për t'i shqyrtuar në hollësi kërkesat buxhetore si dhe mungesën e të dhënave me kohë dhe të kriterëve për ndarjet buxhetore. Mungesa e dëgjimeve të rregullta buxhetore me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial si dhe mungesa e të dhënave të krahasueshme me vendet e tjera janë

nave me kohë dhe të kriterëve për ndarjet buxhetore. Mungesa e dëgjimeve të rregullta buxhetore me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial si dhe mungesa e të dhënave të krahasueshme me vendet e tjera janë

disa nga arsyet që mund të çojnë në kapacitete të kufizuara buxhetore të KGJK-së dhe KPK-së për t'i përmbushur efektivisht misionet e tyre", është thënë në komunikatën e GAP-it. Më tutje është theksuar se në këtë raport nuk është gjetur ndonjë dëshmi se partitë politike në pushtet qëllimisht kanë dashur të ndërhyjnë në pavarësinë e sistemit gjyqësor, por as Ministria e Financave e as Kuvendi i Kosovës nuk kanë mundur të ofrojnë arsye të përsëritshme për të refuzuar kërkesat buxhetore të KGJK-së dhe KPK-së. Procesi i buxhetimit për këto dy institucione është analizuar edhe kundrejt rekomandimeve të Këshillit të Evropës. Raporti ofron

një numër rekomandimesh se si të përmirësohet procesi buxhetor për gjyqësorin. "Siç rekomandohet nga Këshilli i Evropës, përfshirja e KGJK-së dhe KPK-së gjatë ndarjeve buxhetore duhet të jetë e detyrueshme dhe të sigurohet me ligj. Kuvendi i Kosovës duhet të përdorë pika referuese dhe të sigurojë argumente transparente për publikun kur mbështet ose refuzon kërkesat buxhetore të KGJK-së dhe KPK-së. Ligji për ndarjet buxhetore duhet të dorëzohet në Kuvendin e Kosovës të paktën tre muaj përpara fillimit të vitit fiskal në mënyrë që komisioneve t'u jepet më shumë kohë për vlerësimin e kërkesave buxhetore", është thënë në komunikatën e Institutit GAP.

## Në Gazimestan serbët shënojnë Vidovdanin

**PRISHTINË, 28 QERSHOR** - Serbë nga Kosova dhe rajoni shënuan të premtën Ditën e Shën Vidit, e njohur edhe si Vidovdan, në Manastirin e Graçanicës. Kurse manifestimi qendror është mbajtur në Gazimestan, pranë Prishtinës. Liturgjitë u udhëho-

qën nga metropolitani Amfilohije dhe peshkopi Teodosije, së bashku me priftërinj të Kishës Ortodokse Serbe, ndërsa të pranishmëve iu drejtua peshkopi i pensionuar, Atanasije. "Ky është vendi i fitores dhe nuk është i vetmi.

Kemi fitore të mëvonshme në Kosharë dhe Pashtrik. E kemi mundur edhe NATO-n dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës", ka deklaruar Atanasije. Sipas vlerësimeve të Policisë së Kosovës, në ceremonitë në lokacionin e Gazimestanit morën

pjesë 800 deri në 1 000 veta, kryesisht serbë nga Kosova dhe Serbia, porse ka pasur edhe automjete nga Bosnja dhe Sllovenia. Kremtimi i Vidovdanit ndërlihet me përvjetorin e 630 të Betejës së Kosovës, që historia



serbe e njej si fitore shpirtërore të saj, pavarësisht një humbjeje të madhe të forcave ballkanike dhe vrasjes së princit serb Lazar.

# Haradinaj: Kontributi dhe përkushtimi i NATO-s, garanci për paqe dhe siguri në rajon

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 QERSHOR - "Për ne është shumë e rëndësishme që kemi besimin tuaj, të miqve tanë, por ne jo vetëm se ju besojmë juve, por ju ndiejmë si njerëzit tanë, KFOR-in si ushtrinë tonë, mandatin e NATO-s si shërbimin më të mirë për ne, për paqen dhe stabilitetin e vendit tonë", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në fjalën e tij gjatë ceremonisë së ndërrimit të drejtorit të NALT-it, gjeneralbrigade Uwe A. Becker, të cilin nga tash do ta zëvendësojë gjeneralbrigade Michael Oberneyer.

Para të pranishmëve, kryeministri Haradinaj, duke vlerësuar lart kontributin e gjeneralit Becker, ka pohuar se sot janë të gjithë bashkë që të shprehin respekt për shërbimin e më shumë se dhjetë muajsh në

vendin tonë të gjeneralbrigade Uwe Becker.

Kryeministri Haradinaj gjatë fjalës së tij ka veçuar se është takuar në disa raste me gjeneralin Becker dhe se sot është momenti që t'i themi faleminderit për shërbimin, në emër të tij dhe të popullit të Kosovës pasi ky, siç ka thënë ai, është një çast special që popullit gjerman t'i themi faleminderit për kontributin e më shumë se 20 vjetëve që nga koha e tragjedisë e deri sot.

Ndër të tjera, kryeministri Haradinaj ka shtuar se Kosova i takon botës së paqes të udhëhequr nga Amerika. "Me luftën tuaj ju qëndruar në të drejtën tonë dhe ndalet tragjedinë e asaj kohe duke na ndihmuar neve që sot të jemi këtu", është shprehur kryeministri Haradinaj. Ai gjeneralit Becker ia ndau medaljen e kryeheroit "Gjergj Kastrioti



Skënderbeu" për meritën e veçantë gjatë shërbimit në Kosovë. Drejtori i NALT-it, gjeneralbri-

gade Uwe Becker, ka falënderuar institucionet për bashkëpunimin, duke thënë se gjatë detyrës së tij si drejtor i

NALT-it, Kosova mori vendimin për ta filluar tranzicionin gradual të FSK-së. Siç tha ai, me miratimin e mandatit të ri të FSK-së aleatët kanë filluar procesin e rishqyrtimit të nivelit të angazhimit të NATO-s me FSK-në, proces ky që është në vazhdim e sipër. "Në kuadër të mandatit tonë, ne kemi vazhduar të punojmë krah për krah me kolegët tanë të FSK-së në një mjedis të privilegjuar të transparencës dhe çka është më e rëndësishmja, të besimit", ka deklaruar gjeneral brigade Becker.

Në këtë ceremoni nga një fjalë e mbajtur edhe ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneral Lorenzo D'Addario dhe drejtori i ri i NALT-it, gjeneralbrigade, Michael G. Oberneyer.

## Bytyqi: Korniza kombëtare e vlerësimit të nxënësve, dokument i rëndësishëm



PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të premtën në takimin e Kolegjiumit të Drejtorëve të DKA-ve, ku është bërë prezantimi i Kornizës Kombëtare të Vlerësimit të Nxënësve. Në këtë takim, ai ka theksuar rëndësinë e madhe që ka ky dokument pasi, siç ka thënë ministri, vlerësimi është i rëndësishëm për çdo sektor, e sidomos kur bëhet fjalë për vlerësimin e nxënësve. "MASHT-i ka obligim

të krijojë një infrastrukturë ligjore, e cila ua lehtëson punën edhe mësimit dhe nxënësve, por edhe institucioneve që të kenë mundësi ta aplikojnë shumë më lehtë vlerësimin e nxënësve. Ka pasur disa lloje të vlerësimeve dhe kjo ka qenë edhe arsyeja e hartimit të Kornizës Kombëtare të Vlerësimit të Nxënësve, e cila bazamentin e ka në Kurrikulë, në Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe në Udhëzimin Administrativ që

rregullon këtë çështje", ka thënë Bytyqi. Në këtë takim, ministri Bytyqi ka theksuar se vlerësimi duhet t'i ketë dy role kryesore; ta vlerësojë sistemin arsimor parauniversitar në mënyrë që të merren masa për zhvillim si dhe vlerësimi të jetë i përgjithshëm dhe i barabartë për të gjithë nxënësit. "Për të qenë i barabartë vlerësimi, padyshim se mësimit duhet të kenë një kredibilitet dhe një etikë të lartë të punës", është shprehur ministri Bytyqi.

## Zgjedhen pesë anëtarët e Këshillit Drejtues të UP-së

Anëtarë të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" janë zgjedhur: Bedri Bahtiri, Alberta Troni, Zenun Halili, Kemajl Bislimi dhe Naser Kabashi

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka zgjedhur pesë anëtarë të Këshillit Drejtues. Zgjedhja e këtyre anëtarëve është bërë me votim të fshehtë. Anëtarë të Këshillit Drejtues të UP-së janë zgjedhur: Bedri Bahtiri, Alberta Troni, Zenun Halili, Kemajl Bislimi dhe Naser Kabashi.

Këshilli Drejtues i Universitetit është organi kryesor qeverisës i universitetit. Ai ka përgjegjësi të

përgjithshme strategjike për funksionimin efektiv institucional të universitetit dhe është përgjegjës për të gjitha vendimet në lidhje me çështjet financiare (buxheti, personeli, infrastruktura), në mënyrë që të sigurojë kushte të përshtatshme për veprimtarinë e qëndrueshme të universitetit në përputhje me obligimet e tij.

Këshilli Drejtues, kolektivisht, i raporton ministrisë dhe është

përgjegjës për shfrytëzimin e duhur e në mënyrë efektive të fondeve që ministria ose ndonjë burim tjetër publik ia ka ndarë universitetit.

Këshilli Drejtues përbëhet nga nëntë anëtarë me të drejtë vote. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë emëron katër anëtarë me të drejtë vote dhe ata emërohen sipas dispozitave të Ligjit mbi Arsimin e Lartë, ndërsa Senati zgjedh pesë anëtarë të Këshillit Drejtues me të drejtë vote nga personeli akademik i universitetit. Rektori dhe sekretari i përgjithshëm i universitetit janë anëtarë ex-officio të Këshillit Drejtues pa të drejtë vote.



## OEK-u shënon 20-vjetorin e rifunksionalizimit, kritikohen politikat ekonomike



EPOKA E RE  
Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka shënuar të premten 20-vjetorin e rifunksionalizimit të kësaj ode. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka falënderuar të gjithë ata që para 20 vjetëve punuan që OEK-u të kthehet dinjitetshëm dhe të shndërrohet në një institucion serioz dhe të besueshëm. "Secili institucion në këtë vend në këta 20 vjet e ka dhënë kontributin e vet që ky vend të jetë më mirë, por edhe ne besojmë se Oda Ekonomike e Kosovës ka arritur të japë një kontribut qoftë edhe simbolik për zhvillimin e këtij vendi", ka thënë Rukiqi.

Kryetari i parë i pasluftës së Odës Ekonomike të Kosovës, Ismail Kastrati, ka kujtuar ditët e para të qershorit 1999 kur mori drejtimin e OEK-ut dhe filluan punën. Ai ka thënë se fillimisht kishin evidentuar dëmet që kishin pësuar Kosova gjatë luftës së fundit në Kosovë, duke paraqitur gjendjen ekonomike të kohës dhe më pas krijimin e urave të bashkëpunimit mes bizneseve të Kosovës dhe atyre të rajonit. Ish-kryetari i OEK-ut, Ismail Kastrati, ka folur rreth situatës aktuale ekonomike në vend. Ai ka shprehur kritika ndaj politikave ekonomike, duke fajësuar fenomenet negative si korrupsionin dhe nepotizmin që kanë ndaluar hovin e investitorëve të huaj. "Kosova edhe më tutje mbetet vend i

pazhvilluar me halle të mëdha ekonomike. Në Kosovë nuk po udhëhiqet një politikë e mirëfilltë ekonomike në mungesë të sistemit juridik, të korrupsionit, krimin ekonomik, klientelizmit dhe nepotizmit. Ambienti biznesor nuk është i favorshëm për të tërhequr investime të jashtme", ka thënë Kastrati.

Ai ka shtuar se mesatarisht rritja e GDP-së në 20 vjet në Kosovë ka qenë 4.8 për qind, që është më e vogël se rritja në kaq vite në vendet e pazhvilluara që është 5.3 për qind, që do të thotë se Kosova nuk e ka zënë as hapin e zhvillimit të shteteve të pazhvilluara. Për kontributin e dhënë në Odën Ekonomike të Kosovës janë nderuar me mirënjohje disa personalitete.

## Zgjatet deri më 12 korrik afati për aplikim për pagesa direkte dhe grante investive

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka vendosur që afati për aplikim për pagesa direkte - subvencione për kulturat bujqësore dhe projektet e zhvillimit rural - grantet investive për vitin 2019 për masën 101, për masën 103, për masën 302, për masën e ujitjes së tokave bujqësore dhe për masën 303 të zgjatet deri më 12 korrik.

Kjo zgjatje e periudhës për aplikim po bëhet për shkak të kërkesave të fermerëve dhe Drejtorive Komunale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, duke iu mundësuar në këtë mënyrë aplikimin të gjithë fermerëve dhe ekonomive bujqësore.

Procedurat e aplikimit dhe dokumentacioni mbetet i njëjtë.

Afati për aplikim për pagesa direkte - subvencione - ishte paraparë të mbyllet më 30 qershor, ndërkaq ai për projektet e zhvillimit rural - grantet investive - më 1 korrik.



Ministria e Bujqësisë në programin e sivjetmë ka paraparë subvencione për sipërfaqet e mbjella të grurit, të farës së grurit, të elbit, të thekrës, të tërshërës, të misrit, të lulediellit, për

vreshtat ekzistuese, verë të prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht, për pemishtet ekzistuese, për sasinë e dorëzuar - shitur të frutave të mjedrës, për prodhimtarinë e materialit fidanor

të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesat vegetative, për sipërfaqet e mbjella me perime, për bujqësi organike, për lopë dhe buallica qumështore, dele, dhi, bletë,

për pula vojse, për thëllëza, për dosa në riprodhim, për primin e sigurimit bujqësor për kulturën bujqësore të mjedrës, për sasinë e dorëzuar - shitur të duhanit.

## Matoshi kërkon urgjentisht fillimin e hetimeve për rastin e paraqitur nga deputeti Milaim Zeka

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka kërkuar zyrtarisht nga organet e hetuesisë që të fillojnë menjëherë hetimet në lidhje me rastin e paraqitur nga deputeti Milaim Zeka në seancën e së premtes në Kuvendin e Republikës së Kosovës rreth ndërtimit të një hoteli në Brezovicë. "Ministri Matoshi është falënderues

ndaj deputetit Milaim Zeka dhe secilit qytetar tjetër që ndihmon ministrinë dhe organet e tjera shtetërore në luftimin e korrupsionit dhe dukurive të tjera negative në vend. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbetet i përkushtuar që në kuadër të kompetencave të veta t'i hapë të gjitha dyert dhe rrugët për hetimin e këtij rasti dhe siguron organet e

hetuesisë se askush brenda MMPH-së nuk do të lejohet ta pengojë këtë proces", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Në këtë njoftim theksohet se kërkesa e ministrit Matoshi drejtuar organeve të hetuesisë shpreh vullnetin dhe përkushtimin e MMPH-së që ky rast të zbardhet sa më shpejt.





# Debati për homologimin e automjeteve përfundon pa asnjë vendim

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Seanca e jashtëzakonshme lidhur me shërbimin e homologimit të automjeteve ka përfunduar të premtën pa asnjë vendim. Edhe pse u debatua me orë të tëra, në fund deputetët nuk i votuan propozimet e iniciuesit të kësaj seance.

Lutfi Zharku ka shtuar edhe një vendim që duhet të merret nga Kuvendi pas tri të tjerave që propozoi në fillim të seancës. "Vendimi që duhet të merret është: 1. Të shfuqizohet udhëzimi administrativ për procedurën për homologim i Ministrisë së Infrastrukturës;

2. Të hyjë në fuqi një udhëzim administrativ i ri; 3. Deri në fund të vitit të liberalizohet tregu i homologimit të automjeteve; dhe 4. Urgjentisht të merren masa për ndryshime legjislative që të ndërrohen monopolet", ka thënë Zharku. Por, në fund, seanca e jashtëzakonshme është mbyllur pasi nuk pati kuorum për vendimmarrje.

Grupet parlamentare të partive politike gjatë kësaj seance kanë dhënë qëndrimet e tyre përkitazi me procesin e homologimit të automjeteve. Deputeti i AAK-së, Ahmet Isufi, ka thënë se e vetmja mënyrë për ta ndryshuar këtë gjendje është ndryshimi i Ligjit

për automjete. Shqipe Pantina nga grupi parlamentar i PSD-së ka thënë se janë kundër monopolit i cili u ka mundësuar individëve të përfitojnë shumë nga buxheti i shtetit.

Ndërkaq Bilall Sherifi nga grupi parlamentar i Nismës Socialdemokrate ka pohuar se janë për konkurrencë të lirë dhe se angazhohen për ta rregulluar këtë fushë me ligj të veçantë.

Shefi i grupit parlamentar i LV-së, Gluk Konjufca, ka thënë se në rastin e homologimit janë bërë dy krime, njëri në vitin 2008, kur është nënshkruar kontrata, tjetri tash kur iu ka vazhduar kontrata. "Në rastin e homologimit i kemi dy

krime: i pari është në vitin 2008 kur udhëzimin administrativ e ka marrë Fatmir Limaj, duke e keqinterpretuar qëllimisht ligjin për siguri në komunikacion, e shkruan një udhëzim administrativ duke e pasur në mendje një kompani të caktuar dhe bën kontratë. Krimi i dytë është bërë kur kësaj kontrate i është ofruar fundi dhe në vend se ta shfrytëzojë rastin për ta ndërprerë kontratën, Pal Lekaj e merr udhëzimin administrativ që ia siguron vazhdimësinë monopolit në homologim kompanisë 'Eurolabi'. Këto dy krime janë antikushetuese", ka thënë Konjufca.

Deputeti i Nismës

Socialdemokrate, Enver Hoti, iu ka reaguar deklaratave të Glauk Konjufcës për çështjen e homologimit, duke mbrojtur liderin e tij, Fatmir Limaj. "Glauku u fut në mashtrim dhe propagandë, por s'po mund ta barttë propagandën. Kur e pati marrë LV-ja pushtetin në Prishtinë mori vendim për leje të ndërtimit. Por, çka ka ndodhur dhe si ka rrjedhur zhvillimi i planit urbanistik. E dini besoj. I keni ndaluar lejet derisa e keni gjetur rrugën e mirëkuptimit me kompani private për interesa financiare dhe grupe. Mirë do të ishte t'u jepni përgjegjësi qytetarëve të Prishtinës për këtë çështje", ka thënë Hoti.



## Lluka: Nga 14 prilli 2020 Kosova do t'i kontrollojë kufijtë e vet energjetikë

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se nga 14 prilli i vitit 2020 Kosova do t'i kontrollojë kufijtë e vet energjetikë. "Operatorët e transmiseve të Evropës kontinentale kanë votuar pro pavarësisht energjetik të Republikës së Kosovës. Po ashtu, kanë votuar kundër ankesës së Serbisë lidhur me këtë drejtim, duke i dhënë vulën përfundimtare pavarësisht energjetik. Ky pro-

ces do ta aktivizojë linjën e transmissioinit me Shqipërinë, duke krijuar mundësi fantastike për përdorim më të mirë të energjisë në mes të dy vendeve tona", ka shkruar Lluka në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas tij, e gjithë kjo duke iu falënderuar punës së palodhshme të të gjithë aktorëve energjetikë, në veçanti menaxhmentit të KOSTT-it dhe Qeverisë gjermane për përkrahjen e vazhdueshme që kanë dhënë.



## Ambasada e Francës sjell në Prishtinë dy shefa të kuzhinës franceze

Prishtinë, 28 qershor (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se Ambasada e Francës në Kosovës ka sjellë në kryeqytet dy shefa të kuzhinës franceze të cilët do t'i ndajnë përvojat e tyre

në gatim me nxënësit e Shkollës së Mesme "Abdyl Frashëri". "Christophe Dovernge dhe Nathalie Vitton janë dy kuzhinierët francezë të cilët kanë ndarë përvojat e tyre në

kulinari dhe artin e gatimit me nxënësit e Shkollës së Mesme të Agrobiznesit dhe Teknologjisë 'Abdyl Frashëri' dhe më pas kanë mbajtur një garë gatimi. Falënderojmë qeverinë dhe

Ambasadën e Republikës së Francës për mbështetjen dhe bashkëpunimin me Komunën e Prishtinës në fushën e arsimit dhe të kulturës", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



## Projekte milionëshe për Ferizaj në fushën e mjedisit

FERIZAJ, 28 QERSHOR (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, ka vizituar Komunën e Ferizajt, ku është pritur në takim nga kryetari i kësaj komune, Agim Aliu. Gjatë kësaj vizite Matoshi ka konfirmuar mbështetjen e kësaj ministrie në projekte të ndryshme mjedisore dhe vepra të rëndësishme të veçantë strategjike për mjedisin në territorin e Ferizajt.

Aliu e ka njoftuar ministrin Matoshi për hapat e ndërmarra nga qeverisja lokale në dobi të infrastrukturës mjedisore si dhe projeksioneve për të ardhmen, duke vënë theksin te projekti i rregullimit të shtratit të lumit "Sazli", funksionalizimi i bifurkacionit të lumit "Neredime" si dhe ndërtimi i

parkut memorial të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai ka thënë se shumë shpejt do të nënshkruajnë me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit disa memorandume për nisjen e procedurave dhe lehtësimin e realizimit të tri projekteve të cilat janë pjesë e kodeve buxhetore në kuadër të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Aliu ka thënë se rregullimi i shtratit të lumit "Sazli" deri në derdhjen e njërës nga degët e lumit "Nerodime" në lumin "Sitnica" do të kushtojë 500 000 euro, ndërsa funksionalizimi i bifurkacionit të lumit "Neredime" ka vlerën afërsisht 300 000 euro.

Kryetari Aliu ka falënderuar MMPH-në për mbështetjen me grante në vlerë prej 600 000



eurosh për makineri të mirëmbajtjes dhe me grantin e performancës në vlerën e 150 000 euro për angazhimin e Ferizajt në fushatën "Ta pastrojmë

Kosovën". Ndërsa ministri i MMPH-së, Fatmir Matoshi, ka thënë se janë në fazën e hartimit të buxhetit për vitin e ardhshëm dhe se Komuna e

Ferizajt do të përfitojë projekte milionëshe në fushën e mjedisit. Në këtë kontekst, ai ka folur për 1.2 milion euro të cilat do të dedikohen për Ferizajn.

## Asfaltohet mbi një kilometër rrugë në lagjet e Damanekut në Malishevë



MALISHEVË, 28 QERSHOR (ER) - Në fshatin Damanek të Komunës së Malishevës janë asfaltuar rreth 1 100 metra rrugë nëpër lagje. Asfaltimi e rrugëve e kanë parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, dhe drejtori i Inspektoratit, Dibran Kastrati, të cilët edhe janë takuar me banorët e fshatit. "Këto rrugë janë pjesë e investimeve që jemi duke i bërë në të gjitha fshatrat e Komunës së Malishevës. Ne jemi duke e bërë të pamundurën që

brenda buxhetit të pamjaftueshëm që kemi si komunë t'i realizojmë kërkesat e banorëve të të gjitha fshatrave. Na mbetet ta vazhdojmë realizimin e projekteve të tjera në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës", ka thënë nënkryetari Berisha gjatë takimit me banorët e Damanekut.

Rregullimi dhe asfaltimi i këtyre rrugëve është mundësuar nga buxheti i Komunës së Malishevës dhe realizohet në kuadër të listës së projekteve kapitale.

## Prizreni nis fazën e parë të dezinfektimit

PRIZREN, 28 QERSHOR (ER) - Në kuadër të shërbimeve për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim të qytetit, që është duke u zhvilluar nën menaxhimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka filluar faza e parë e dezinfektimit në Prizren.

Të pranishëm gjatë këtij

aksioni ishin kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, dhe drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Egzon Elshani. Dezinfektimi ka për qëllim parandalimin dhe asgjësimin e insekteve fluturore në mënyrë që të ruhet shëndeti publik i qytetarëve duke bërë pengimin

e përhapjes së sëmundjeve që barten nga këto grupe.

Shërbimi për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim po realizohet qe një javë, duke filluar nga 21 qershori, ku janë trajtuar të gjitha zonat e parashikuara sipas planit dinamik për kryerjen e këtyre shërbimeve.



## Disa të rinj me idetë e tyre kreative po zbukurojnë qytetin e Suharekës

SUHAREKË, 28 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, është takuar me disa të rinj dhe të reja të cilët me ide kreative


janë duke i ngjyrosur disa nga hapësirat publike në këtë komunë. Me këtë rast, Muharremaj ka thënë se në hyrje të qytetit nga Shiroka, Suhareka

do ta ketë një pamje krejtësisht tjetër dhe të bukur. "Natyrishë se e ardhmja kërkon ide kreative dhe me rininë po krijojmë hapësira që, mes të tjerash, kanë

edhe art. Qyteti i ngjyrave po rrjedh si ide dhe po merr formë. Në hyrje të qytetit nga Shiroka do ta keni një pamje tjetër", ka thënë Muharremaj.



# Zgjedhjet, protestat dhe dekretet



Rexhep QOSJA

Zhvillimet politike në Shqipëri i përcjell rregullisht në mediet elektronike dhe të botuara të Tiranës dhe të Prishtinës.

Zhvillimet politikë në Shqipëri (e në Kosovë) tani e sa kohë më shkaktojnë dëshpërim, kur e kur dëshpërim e trishtim.

Këto zhvillime politike i vështroj dhe për to mendoj duke i kujtuar epokat më të shënuara me arritjet e me pësimet e tyre në historinë shqiptare.

E këto janë katër epoka.

E para është epoka e Skënderbeut, si Epokë e Veprimit, në të cilën mbrohej populli dhe mbrohej vendi prej sulmeve të pandalshme të Perandorisë Osmane. Figurat politike të kësaj Epoke ishin figura me integritet të lartë shoqëror e moral.

E dyta është Epoka e Rilindjes Kombëtare, si Epokë e Mendimit, në të cilën qëllim dhe ideal ishte krijimi i Shqipërisë shtet, që atëherë sundohej prej Perandorisë Osmane dhe i shqiptarit, që atëherë shpirtërisht sundohej prej Stambollit, prej Vatikanit e prej Athinës. Figurat politike e intelektuale të kësaj Epoke

ishin figura politike e intelektuale me përkushtim të lartë kombëtar, me ndërgjegje të lartë shoqërore e me integritet të lartë mendor. Ishte kjo epokë e mendjes dhe etikës më shembullore në historinë shqiptare. Epoka e tretë është Epoka e Socializmit komunist, si epokë e Mendimit totalitar dhe e Veprimit diktatorial, në të cilën me mjete të totalitarizmit mendor dhe veprues ndërtohej e forcohej shteti dhe ndërtohej e forcohej vetëdija kombëtare. Figurat politike të kësaj epoke në të gjitha pikëpamjet ishin të uniformizuara.

Epoka e katërt është kjo epoka e jonë, si epokë e quajtur e Demokracisë. Por, kjo demokraci, si po tregon praktika e saj partiake, politike e shtetërore, është demokraci e gënjeshtërt. Në klasën politike të kësaj epoke, si po shihet qartë, mbizotërojnë njerëz politikë të papërgjegjshëmri politike, shpesh të paetikë në mendimet dhe në veprimet e tyre.

Në vend se me reforma politike, shoqërore e shtetërore, që do të sillnin përmirësimin e jetës së popullit, që mund të bëhen të qëndrueshme vetëm duke kultivuar shkencën, kulturën, shpirtësinë, pjesëtarët e kësaj klase politike kujdesin e tyre më të madh ia kushtojnë posteve pushtetore dhe veprimeve politike, partiake e shtetërore gjithnjë duke pasur parasysh në radhë të parë interesat vetjake. Për këtë arsye korrupsioni, nepotizmi dhe

privilegjet e shumëllojshme janë bërë emërtuesi themelor "historik" i veprimtarisë partiake dhe pushtetore në këtë epokë në Shqipëri e në Kosovë. Po të vazhdojë edhe më tej mbizotërimi i këtij mentaliteti politik e shtetëror, Epoka e filluar para tridhjetë vitesh, do të shënohet në historinë shqiptare si Epokë e gënjeshtërisë që ka pushtuar të vërtetën, e mashtrimin që ka pushtuar sinqeritetin, e padrejtësisë që ka pushtuar drejtësinë, e papërgjegjshmërisë që ka pushtuar përgjegjshmërinë, e mujshtërisë që ka pushtuar bashkëpunimin, e dhunës që ka pushtuar demokracinë, e çmoralizimit që ka pushtuar nderin dhe e një vargu të këqijash të tjera.

Kriza e sotme politike e institucionale në Shqipëri, e nisur, e vazhduar dhe rrezikshëm e acaruar prej kryetarit të përparshëm, Sali Berisha dhe prej kryetarit të tanishëm të PD-së, Lulzim Basha, e plotësuar mjerisht prej anshmërisë partiake të kryetarit të Shqipërisë, Ilir Meta, dhe e shtuar me disa masa e me disa paraqitje të paliruara prej gjykimesh kur e kur cenuese të kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, e shton ndjenjën e pasigurisë të nënshtetasve shqiptarë që po e shton edhe ikjen e tyre prej vendit të vet dhe e krijon një pamje shumë të përkeqësuar të Shqipërisë në Botë.

Djegia e mandateve të deputetëve të PD-së dhe të

partive të tjera që me të përbëjnë opozitën, me çka janë fyer votuesit që ua kanë dhënë votën, i bën moralisht të pabindshme kërkesat e tyre dhe jodemokratike protestat e tyre.

Edhe për këtë arsye zgjedhjet e 30 qershorit mund të quhen të kundërshtuara prej një Opozite prej së cilës objektivisht nuk mund të jenë të kundërshtuara: prej një Opozite e cila duke djegur mandatat e deputetëve realisht e ka djegur vetëligjshmërinë! Zgjedhjet e 30 qershorit, prandaj, mund të mbahen. Mbajtja e tyre bëhet edhe më e arsyeshme qoftë edhe pse janë të pranuar prej atyre shteteve që janë me ndikimin më të madh, më të dëshiruar e më vendimtar politik, shtetëror e shoqëror në jetën dhe në politikën shqiptare: prej ShBA-ve, prej Mbretërisë së Bashkuar dhe prej shteteve të Bashkimit Evropian.

Nuk mund të kërkohej anulimi i zgjedhjeve, nuk mund të kërkohej largimi i kryetarit të partisë që ka fituar zgjedhjet - të kryetarit të Partisë Socialiste, prej një partie, prej një opozite, që bën përpjekje të vijë në pushtet me kërkesa të tilla, që bën përpjekje të vijë në pushtet jo me zgjedhje po me protesta në të cilat mjete themelore janë gënjeshtër, shpifjet, akuzat e pamatshme dhe dhunat e ndryshme.

Nuk mund të kërkohej anulimi i zgjedhjeve dhe nuk mund të kërkohej përmbyjsja e qeverisë

siç po kërkon Partia Demokratike me aleatët e saj duke e tejshtëmtuar pamjen e shtetit kombëtar, pamjen e Shqipërisë, para botës me gjithfarë akuzash e gjithfarë shpifjesh.

Nuk mund të kërkohej shtyrja e zgjedhjeve dhe përmbyjsja e kryeministrit dhe Qeverisë pa menduar se ajo shtyrje dhe ajo përmbyjsje kanë pasoja politike, institucionale, kushtetutare, shtetërore që nuk e sjellin tejkalimin por përshtirjen e krizës.

Me gjithë të metat, gabimet, lëshimet, premtimet e parealizuara, gjuhën politike kur e kur të palejueshme të kryeministrit Edi Ramës, zgjedhjet e 30 qershorit do të jenë më premtuese se sa mohimi i tyre për zgjidhjen e krizës shqiptare. Mbas këtyre zgjedhjeve do të duhej të bëhej çmos për organizimin e bisedimeve politike mes palëve të krizës dhe atëherë do të mund të mendohej dhe do të mund të pranohej mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme jo vetëm vendore por, pse jo, edhe të përgjithshme.

Shqipëria ka shumë nevojë për një katarsis që do të nënkuptonte llogaridhënie politike e shtetërore për tensionet, konfliktet, helmimet shpirtërore disavjeçare që po përjeton populli shqiptar. Dhe, kjo llogaridhënie do të duhej t'u paraprinte reformave që do të duhej të bëheshin së pari në vetë partitë e mandej në përbërësit kryesorë institucionale të shtetit shqiptar në përgjithësi. /Dritare.net/

## Promovohen dhjetë vëllimet e rrëfimeve nga 100 pleq dhe plaka

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" promovuan botimin e librit në dhjetë vëllime "Kujtesa e Kosovës", 100 rrëfime nga 100 pleq dhe plaka. I pranishëm në këtë promovim ishte edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi.

100 rrëfime autentike shpalosin gjithë botën e përditshmërisë në Kosovë, që nga Lufta e Dytë Botërore deri sot, e që vijjnë në rreth 5 000 faqe transkriptesh të 100 intervistave me 100 pleq dhe plaka të moshës mbi 80 vjeç.

Temat të cilat u trajtuan në historitë gojore ishin tema mbi organizimin e jetës, zakonet, organizimin e fshatit, duke përfshirë këtu zakonet ekonomike dhe marrëdhëniet tregtare brenda dhe jashtë vendit. Me këtë rast, ministri Gashi ka thënë se me ndihmën dhe kontributin e bashkëpunëtorëve të ndryshëm,

profesorëve, studentëve, bibliotekarëve, ky botim shënon përfundimin e realizimit të projektit të rrëfimeve të 100 pleqve e plakave dhe një fillim të ri për ndërtimin dhe zhvillimin e një projekti afatgjatë për ruajtjen e kujtesës së Kosovës. "Ky projekt më ndryshe dhe më gjithëpërfshirës ka mbledhur, dokumentuar, publikuar dhe po promovon historitë gojore të personave të moshuar të Kosovës, duke 'zënë kështu hapin' për grumbullimin e historive jetësore të një periudhe jo mjaftueshëm të dokumentuar, që të mos themi fare pak të dokumentuar, periudhë kjo e vuajtjes, e vetëmohimit, e flijimit të njerëzve të Kosovës", ka thënë ministri Gashi.

Gashi ka shtuar se realizimi i këtij projekti vjen edhe pas trajnimit të ekipit punues nga ligjëruesit profesionistë të fushës së historisë gojore, mbështetur nga Ambasada Amerikane në Kosovë. Po ashtu, ministri Gashi



ka konfirmuar se Ministria e Kulturës do ta përkrahë Bibliotekën Kombëtare të Kosovës edhe më tutje që të mbledhë dhe t'i ruajë rrëfimet biografike autentike të njerëzve të Kosovës, duke përzgjedhur ata që kanë çfarë të rrëfijnë për jetën e tyre, për përjetimet e tyre të

ruajtura në kujtesën e tyre, si dhe këto rrëfime të botuara në shqip, të përkthehen edhe në gjuhën angleze që të bëhen të qasshme edhe për përdorues të huaj. "Sot, në mesin tonë, gjenden ata të cilëve u atribuohet rezultati i mbledhjes së 100 historive. Rrëfimtari të historive tuaja

plaka e pleq të urtë, që kanë përjetuar dhe gjëra që nuk i përthekon mendja e njeriut. Ju falënderojmë përlulësisht që hapët dyert e zemrat tuaja për të treguar me zërin tuaj, jetën tuaj dhe atë të komunitetit, ashtu si e kujtoni dhe ashtu siç ju është treguar", ka thënë Gashi.

## Demokratët shtyjnë përpara projektligjin për siguri në zgjedhje

UASHINGTON, 28 QERSHOR - Dhoma e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara ka miratuar një legjislacion që synon të garantojë siguri zgjedhore pas ndërhyrjes kibernetike ruse në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016. Projektligji i hartuar nga demokratët parasheh auditim paszgjedhor dhe zëvendësim të pajisjeve të vjetërsuara. Ky dokument është miratuar me 225 vota për dhe 184 kundër. Aty, po ashtu, përmendet që

shtetet amerikane duhet të pranojnë qindra miliona dollarë nga fondet federale për t'i siguruar makinat e votimit nga sulmet kibernetike.

Pas hetimeve dyvjeçare të kryera nga këshilltari special Robert Mueller, është përfunduar se Rusia ka ndërhyrë në zgjedhjet e vitit 2016, në një "stil sistematik", përfshirë hakimin.

Demokratët e Kongresit kanë shtyrë përpara votimin e këtij projektligji teksa partia e tyre

përgatitet për ta sfiduar presidentin aktual Donald Trump në zgjedhjet e vitit të ardhshëm.

"Viti 2020 është duke ardhur. T'i fillojmë përgatitjet", ka thënë kryesuesi i Komitetit për Inteligjencë përmes një postimi në rrjetin social "Twitter", pas votimit.

Megjithatë, ky dokument përballat me kundërshtime të mëdha në Senatin e kontrolluar nga republikanët.



# Trumpi i kërkon Putinin të mos ndërhyjë në zgjedhje

*Presidenti amerikan Donald Trump dhe homologu i tij rus Vladimir Putin janë takuar në margjina të Samitit të 20 vendeve më të industrializuara në Osaka të Japonisë, ku presidenti amerikan i ka kërkuar Putinin të mos ndërhyjë në zgjedhjet e ardhshme presidenciale*



UASHINGTON, 28 QERSHOR - Presidenti amerikan Donald Trump dhe homologu i tij rus Vladimir Putin janë pajtuar për të punuar për përmirësimin e marrëdhënieve në mes të të dy shteteve, në takimin e tyre të parë, prej kur është publikuar raporti amerikan që konfirmon se Moska ka ndërhyrë në zgjedhjet amerikane.

Në takimin e 28 qershorit, që është zhvilluar në margjina të Samitit të 20 vendeve më të industrializuara në Osaka të Japonisë, Trumpi i ka kërkuar Putinin të mos ndërhyjë në zgjedhjet e ardhshme presidenciale.

Bazuar në një deklaratë të lëshuar nga Shtëpia e Bardhë pas takimit 80-minutësh, tregohet se janë arritur pritshmëritë që nuk kanë qenë të mëdha për këtë takim. "Të dy liderët janë pajtuar se përmirësimi i marrëdhënieve në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë është në interesin e përbashkët të të dy shteteve dhe gjithë botës", është thënë në

deklaratë.

Të dy liderët është thënë të kenë diskutuar edhe për situatën në Iran, Siri, Venezuelë dhe Ukrainë. Ky takim, po ashtu, është i pari pas Samitit të mbajtur në Helsinki në korrik të vitit të kaluar, në të cilin Trumpi nuk ka lejuar askënd të jetë pjesë e diskutimeve dhe ka refuzuar t'i ndajë përfundimet e negociatave me Kongresin.

Takimi i tyre vjen teksa marrëdhëniet në mes të të dy kombeve krahasohen me atë të periudhës pas Luftës së Ftohtë.

Trumpi ka anuluar një takim me Putinin në Samitin G20, që është mbajtur në Argentinë, në

nëntor të vitit të kaluar, pasi Rusia ka kapur dy anije ukrainase dhe ekipet e tyre në Detin Azov. Megjithatë, ata kanë përmendur shumë pak këtë çështje në margjina të atij organizimi.

Në një intervistë për "Financial Times", të publikuar më 27 qershor, Putinin ka thënë se ai "nuk pret ndonjë pikë kthese" gjatë takimeve të tij në Osaka. "Ekziston shpresa që gjatë këtyre diskutimeve të përgjithshme dhe takimeve bilaterale ne do të jemi në gjendje t'i ulim tensionet dhe të krijojmë një bazë për të ardhme më pozitive", ka thënë Putinin.

Bazuar në deklaratën e Shtëpisë së Bardhë, "presidentët janë pajtuar për t'i vazhduar diskutimet në modelin e shekullit 21 për kontrollin e armëve, për të cilin presidenti Trump ka vlerësuar se duhet përfshirë edhe Kinën".

Traktati për Armë Bërthamore me Rreze të Mesme do të skadojë në muajin gusht, pasi ShBA-ja ka akuzuar Rusinë për moszbatim të marrëveshjes, andaj të dy shtetet kanë hequr dorë nga ajo. Traktati, Fillimi i Ri, është një tjetër marrëveshje për armët bërthamore, që mund të skadojë më 2021, nëse të dy shtetet nuk pajtohen për ta vazhduar atë.

Putini ka ripërsëritur se Rusia nuk ka parë interesim nga ShBA-ja për ta vazhduar këtë marrëveshje.

Shtetet e Bashkuara dhe Rusia kanë politika të kundërta edhe kur është fjala për Iranin dhe Venezuelën, ku situata është tensionuar në muajt e fundit.

Si Teherani ashtu edhe Karakasi janë aleatë të Kremlinit dhe janë tregje kyçe për armë ruse. Trumpi synon ta largojë nga pushteti presidentin e kontestuar Nicolas Maduro, meqë situata në këtë shtet ngadalë mund të dalë nga kontrolli. Ai ka kërkuar nga Rusia që ta largojë ekipin e saj të specialistëve nga Venezuela.

## Johnsoni, pesimist për një afrim të mundshëm me Rusinë e Putinin

LONDËR, 28 QERSHOR - Deputeti pro-Brexitit, Boris Johnson, favoriti kryesor për ta pasuar kryeministren britanike Theresa May, shprehu të premtën pesimizmin e tij për sa i përket ngrohjes së marrëdhënieve në mes të Londrës dhe

Moskës për sa kohë presidenti rus Vladimir Putin do të jetë në pushtet. Marrëdhëniet mes dy vendeve janë në nivelin më të ulët që prej helmimit në vitin 2018 të ish-spiunit rus Sergei Skripal në Angli që, sipas Londrës, ky krim është bërë

nga Rusia, ndërkohë që Moska ka mohuar çdo përfshirje. "Kjo çështje ka qenë zhgënjimi më i madh kur isha në Punët e Jashtme", tha Boris Johnson, shef i diplomacisë britanike mes korrikut 2016 dhe korrikut 2018.





## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**

# VAJI I BURRIT DREJT FUNDIT TË BOTËS

## Berat ARMAGEDONI

Gjatë kohës së dimrit, sa ishte në Meksiko Siti, Xhevdet Bajraj më shkroi dhe më njoftoi se verës do të vijë në Kosovë, se do t'i botojë dy libra, se do t'i përurojë që të dytë dhe më porosi: "Thuaju prishtinalive ftofna nja dhjetë gajbe me birra se e kemi njet me i pi". (Xhevdet, i kam njoftuar. Ndoshta, derisa ke ardhur ti, i kanë mërdirë!) Festën e madhe të librit të tij "Kur qajnë hardhitë" e nisëm në fillim të këtij qershori, në Panairin e Librit në Prishtinë, me birra dhe libra në duar. Po e vazhdojmë sonite këtu, po si javë më parë, me shpresë për ta vazhduar diku tjetër në vjeshtë, po kaq mirë, hareshëm, këndshëm dhe ngrohtë si sonite. Librin e Bajrajt "Kur qajnë hardhitë" e ka botuar Shtëpia Botuese "Armagedoni" pa i ndërruar dy fjalë me autorin. Thjesht, nuk kishim çfarë të diskutonim me të as për poezitë e tij, as për hardhitë e vendit të tij, as për vajin, kujtesën kolektive dhe dhembjen tonë të përbashkët. Jo, sepse, një bisedë për këtë libër dhe për poezitë e tij e pata bërë me Xhevdetin kohë më përpara, në dhjetor, për revistën "Akademia", në të cilën, i pyetur kush je ti, ai më qe përgjigjur: "Oh, Xhevdet Bajraj është një kërkues kokëfortë i parajsës së humbur, asaj që e ka krijuar Perëndia për të. Herë i afrohet e herë i largohet, me Kosovën në zemër sikur nuk ka vend për ata të dy aty, kështu që përpiqet, pa sukses, t'i bëjë Kosovës vend në të, se pa të nuk është i tjeri".

Parajsa e tij, e dalë nga dora dhe mendja e tij, është kjo që quhet "Kur qajnë hardhitë". Së këndejmi, atyre shumë pyetjeje që u është përgjigjur në atë intervistë në formë të prozës si, për shembull, kush është Xhevdet Bajraj, përse shkruan, çfarë e mërzi, çfarë e lumturon, çfarë ndien për Kosovën kur është larg saj dhe çfarë ndien për të kur është këtu, ç'punë dhe ç'jatesë bën në Meksiko Siti, si i përjetoj ditët e para të luftës në Kosovë, ato të refugjatit atje dhe të lirisë dhe kthimit në Kosovë, pastaj çfarë është për të poezia, çfarë u flet spanjollëve për Kosovën dhe për genocidin serb në Kosovë e shumë të tjerave, kryesisht për jetën e tij, u është përgjigjur poetikisht dhe paralelisht, në gjuhën shqipe dhe spanjolle, në librin "Kur qajnë hardhitë", i cili është shkruar gjatë vitit të tretë të bursës së Sistemit Kombëtar të Krijuesve Artistikë të Meksikës. Por, edhe pse është shkruar në Meksiko Siti, ky libër topikën e ka në Kosovë, në Rahavec, aty ku mbillet, piqet rushi dhe zihet rakia. Edhe përkushtimin e librit autori e ka për familjen e vet: për Nazmijen, Fadilin, Dritën dhe Besën. Patjetër dhe për ne të tjerët që e gjejmë vetveten në të qysh prej krijimit të ditës së parë teksa mbledhim kujdesëshëm ndodhitë si trohet e bukës dhe teksa numërojmë ditët e bardha dhe të zeza të jetës dhe familjes së tij. Vështruar në tërësi, "Kur qajnë hardhitë" duket si një koleksion miniaturash poetike. Përbrenda



tyre ka portrete, përshkrime, kujtime, njoftime, rrëfime për karaktere njerëzish, skena komike dhe tragjike, skica dhe skeçe. Ai që i luan dhe i shkruan është autori - Xhevdeti. Duke pasur shije të hollë për këtë lloj të shkrimit dhe për përzgjedhje të këtyre miniaturave, kujdes të posaçëm u kushton edhe titujve të tyre, të cilët janë, pjesa më e madhe e tyre, prej 77 poezive në gjuhën shqipe dhe po kaq në gjuhën spanjolle, me vetëm nga një fjalë, kryesisht emra, si: Zana, Ujku, Kësulëkuqja, Kthimi, Kripa, Muza, Këmisha, Vallëzimi, Pështyma, Politika, Pulla, Valixhja, Rrëmbimi, Fajtori, Falja, Qengji, Protesta, Cigarja, Klithja, Vagabondi, Hija, Mësimi e ndonjë tjetër. Këta tituj emërorë i përshatën natyrës së miniaturës, e cila ka ngjarje të vogla, fjalë të pakta, fjali të shkurtra, po mjaft të zgjedhura. Rrush prej figurave stilistike janë këto poezi. Ka në to simbol, ka per-

sonifikim, ka antitezë, ka krahasim, ka metaforë, ka hiperbolë, ka litotë, ka inversion, ka paradoks, ka alegori, ka paralelizëm figurativ. Ka kujtime të mira dhe të këqija. Ankh dhe stres. Krime dhe dëshmi. Foshnja, fëmijë, të rinj, të moshuar, të vjetër. Të gjallë dhe të vdekur. Edhe të vranë në Abri dhe Padalishtë. Edhe prezantim të krimeve e dëmeve të mëdha serbe bërë në Kosovë, duke numëruar rreth 12 000 të vranë, prej tyre rreth 1 400 fëmijë, rreth 1 750 vajza dhe gra. Dmth., poezia e Bajrajt ka, përpos letrar, edhe dimension historik, të historisë më të re të Kosovës. Padyshim se, duke e shkruar poezinë Pa zemër edhe në gjuhën spanjolle, e cila numëron disa prej krimeve serbe në Kosovë, ndërkombëtarizon çështjen e popullit tonë. Më tutje, poezia e tij ka homazh për dëshmorë, heronj, viktima dhe ka mirazh për disa udhëheqës zyrash

të të sakatosurve në beteja të luftës, të cilët mezi s'presin t'i korruptojë dikush. Ka dhe ftesë për protestë të qetë e zë të ngritur kundër atyre që pronën e shtetit e përdorin dhe e keqpërdorin më shumë se pronën e vet private. Ka hakërrimë njerëzore për padrejtësi të ndryshme shoqërore. Që t'i bie më shkurt, "Kur qajnë hardhitë" është libër me poezi dokumentare, është pjellë e luftës së Kosovës dhe lirisë së nëpërkëmbur të saj. Libri nuk ka ilustrime me fotografi dhe faksimile, por ka përshkrime të hollësishme me fjalë. Një këso përmbledhje me ngjarje të luftës e të pasluftës, shkruar në këto përmasa shoqërore, kulturore, arsimore, shkencore, për dëmet njerëzore dhe ekonomike që i janë bërë vendit tonë nga serbët, na ka munguar gjatë dhe shumë. Duke lexuar këtë libër i kujtojmë dy vjetët e luftës, njëzet vjetët e pas luftës, barbarët, luftëtarët dhe komandantët. Dhe, së bashku me hardhitë e Rahavecit dhe së bashku me Xhevdetin, derisa analizojmë tërësinë e temave e të motiveve të tij, duhet të qajmë edhe ne sepse kemi për çfarë. Lufta ka shkatërruar dhe rrëmbyer shumëçka tonën të dashur, por paslufta i ka bërë roje të keqe luftës. Vetëm disa vepra letrare, si kjo sot dhe si ky autor, janë përkujdesur për të kaluarën tonë të përgjakshme. Prandaj, meritojnë nderim të madh. (Shkruar posaçërisht për përuhimin të librit "Kur qajnë hardhitë", organizuar në "Soma Book Station". Prishtinë, datë 28. 06. 2019)



XHEVDET BAJRAJ

## ZYRA PËR HERONJTË E RËNË

Heronjtë do ta kenë luftën e tyre varret e tyre jetimët e tyre të vejat e tyre të cilat në Ditën Ndërkombëtare të Vejushave do të çojnë lule të freskëta në varret e tyre

Udhëheqësit e tyre do t'i kenë zyrat e veta për heronjtë e rënë ku do t'i përtypin ngadalë ditët deri në fund të jetës së tyre

Kur t'u bien ndër mend heronjtë e rënë në shenjë respekti për ta do të marrin një dhomë në një hotel luksoz një shishe verë të kuqe të vitit të rënies së tyre dhe do të bëjnë seks me njërën nga dashnoret e shumta të tyre

## BIXHOZÇIU

Luante poker me jetën dhe humbi Duke u kthyer në shtëpi pa një hajn duke vjedhur unaza dhe dhëmbë ari nga kufomat në varret që ai vetë i kishte hapur

Zbardh dita Një grua lakuriq sapo lëviz perdet hapë dritaren buzëqesh i shtrin krahët sikur do ta përqafojë qiellin

Bixhozçiu ndalet e liron zogun e kuq nga kafazi i krahërorit të tij kthehet prapa dhe nxiton për ta arritur natën që iku

## E DASHURA IME

Ëndërroj që merr frymë pranë meje lakuriq e unë të rri përmbi i varur në mur si Krishti në kryq oh e dashura ime engjëlli im i vdekjes Ti ma përkujton që po të ishte dita edhe pakëz më e gjatë do të mund t'i arrinim të gjitha bashkë që jeta nuk është gjë tjetër përveç një luftë e pafund në të cilën mungon fisnikëria e Don Kishotit dhe përpjekja për t'u kthyer në shtëpi në Itakë në Makondo në Meksiko Siti a në Rahavec atje ku dielli kurrë nuk perëndon

## TRE FËMIJË

Fëmija i familjes së ekzekutuar në Obri nuk e mban mend nëse ka pirë nga biberoni i mbushur me gjakun e nënës së tij të vranë me duart e vrasësve të saj As Afrim Imeraj i vranë në Padalishtë kur nuk e mësoi emrin e atij që ia vodhi dorën e më pastaj jetën

Fëmija trevjeçar sirian që para se të vdiste gjënë e fundit që tha do t'ia tregoj Zotit të gjitha nuk çojnë peshë nëse këto nuk ua hapin sytë zemrave të armiqve nëse këto nuk e ndalin rrotën e përgjakshme të historisë që vazhdon të rrotullohet

Kjo botë e ka të pamundur të kthjelljet pa e nxjerrë njeriu kokën nga xhepi i tij apo i tjetrit

Jeta është film fundi i të cilit dihet



E rrallë


## Po udhëtonte me presidentin drejt G20, oficerja kapet me 39 kilogramë drogë

Një oficer e Forcave Ajrore të Brazilit që po udhëtonte me kontingjentin e G20 të presidentit Jair Bolsonaro u arrestua këtë javë. Ajo u arrestua pasi u kap me 39 kilogramë drogë. Oficerja u kap në Sevilje,



Spanjë, kur avioni bëri një ndalesë në Osaka, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes e Brazilit.

FOTO E DITES



Plazhi i mbushur me njerëz në Gjermaninë perëndimore, ku temperaturat kanë arritur në 38 gradë celsius. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Përdorën Google Maps, rreth 100 shoferë ngecin në baltë

Rreth 100 shoferë, duke u përpjekur të shmangin një bllokim trafiku pranë Aeroportit Ndërkombëtar Denve, ngecën brenda në baltë pasi përdorën Google Maps që iu dha një rrugë



alternative. Disa makina nuk mund të kalonin përmes llumit dhe më pas dhjetëra të tjera u bllokuan pas tyre. Google Maps ka njoftuar se rruga nuk ishte shënuar si private.

## BARSOLETA E DITËS



- Çfarë është një parainfarkt?
- Mos ta gjesë celularin në xhep.
- Po infarkti?
- Kur ta merr telefonin gruaja dhe nuk e ke të bllokuar.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)  
**“THE SECRET LIFE OF PETS 2” 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min  
**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan  
**Regjia:** Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00  
**“X-Men; Dark Phoenix”**

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

**Rolet:** James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain  
**Regjia:** Simon Kinberg



Në ora 20:00

**“MEN IN BLACK; INTERNATIONAL” 3D,**

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

**Rolet:** Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson  
**Regjia:** F. Gary Gray



Ne ora 22:00

**“M A”**

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

**Regjia:** Tate Taylor



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




**DASHI**

Kini kurajë dhe shprehini idetë tuaja. Nuk ju mundon oratoria për ta bërë këtë gjë. Pas disa planifikimeve, do të jeni i gatshëm të veproni.



**DEMI**

Një sintoni e përkryer me partnerin më në fund do t'ju bindë t'i bëni gjërat ashtu siç duhet dhe më seriozisht.



**BINJAKËT**

Nuk duhet të bëheni fosile të zakoneve tuaja, por duhet të çliroheshi nga kjo gjendje. Frekuentoni persona dhe ambiente të reja.



**GAFORJA**

Po zmadhoni kot situata të caktuara, kur në të vërtetë nuk ka ndodhur asgjë. Mbase për shkak të gjendjes shpirtërore ngarkoheni pa shkak.



**LUANI**

Krenaria juaj do të vihet në provë të vështirë sot. Megjithatë nuk e apromoni një veprim të caktuar, kushtëzuar nga rrethanat, nuk do të flisni.



**IRGJËRESHA**

Intuita juaj sot do t'ju vijë në ndihmë ta kuptoni gjendjen shpirtërore të personave që ju rrethojnë në përditshmërinë tuaj.



**PESHORJA**

Nuk keni pse fajësoni veten për diçka që ka ndodhur në të shkuarën. Do t'ju penalizonte për ta ndjekur rrugën tuaj drejt së ardhmes.



**AKREPI**

Tregohuni të kujdesshëm të mos viheni në mes të një situatë që nuk iu përket sepse do t'i vuani pasojat. Personat e përfshirë do t'ju fajësojnë ju për gjithçka.



**SHIGJETARI**

Disa nga ju po planifikojnë të nisen për diku. Mbase kjo gjë do të jetë ajo që duhet dhe ndryshimi që kishit kaq kohë që e prisnit.



**BRICJAPI**

Nëse përqendroheni në fushën profesionale do të arrini të ndryshoni mjaft për mirë statusin tuaj aktual. Do të promovoheni në një ambient të ri.



**UJORI**

Jeni përballë një zgjedhjeje mjaft të vështirë në jetën tuaj. Do të vëreni që nuk keni në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme për ta finalizuar.



**PESHQIT**

Dashuria do të triumfojë mbi gjithçka në ditën e sotme, edhe mbi ato fjalë të thëna pa u menduar në një çast të caktuar.



## Kim Kardashian po mundohet ta krijojë trendin e saj të papuçeve me take



**G**jatë javëve të fundit ylli televiziv Kim Kardashian është parë duke veshur papuçe me rrip dhe me take. Papuçet me rrip dhe take ajo i ka veshur në raste të ndryshme, madje

edhe me veshje sportive duke nxitur kështu pyetjen se a po mundohet Kim Kardashian ta krijojë një trend të saj? Së fundmi, papuçet me rrip dhe take i ka veshur gjatë një shëtitjeje në Nju Jork.



## Kylie iu rikthehet fansave me hitet e saj

**K**ylie Minogue ka publikuar albumin e ri muzikor. Këngëtarja 51-vjeçare fansave ua dhuroi "Step Back In Time", një përmbledhje të hiteve të saj më të mëdha. Gjatë intervistës së fundit, Kylie foli rreth performacës së saj në festivalin Glastenbury 2019 për herë të

parë që kur u tërhoq nga muzika para 14 vjetësh për shkak të diagnostikimit me kancer të gjirit. "Do të kujtoj se çfarë ndodhi qatë atyre viteve të kaluara dhe ndjenja ime kryesore do të jetë vetëm mirënjohje dhe se sa e brishtë mund të jetë jeta", ka thënë ajo për "The Mirror".

## Demi Lovato sjell përjetimet në albumin e ri



**N**jë album muzikor do të jetë shtëpia e sekreteve ku Demi Lovato do ta shpalosë gjithë të vërtetën personale të asaj që kishte përjetuar vitin e kaluar. "E dini çfarë është e bukura e të bërit një album? Mund të thuash gjithçka që dëshiron, të jesh e hapur dhe e sinqertë aq sa

është e mundur dhe më në fund ta tregosh anën tënde të historisë, pavarësisht se disa nuk mund ta pëlqejnë", ka shkruar këngëtarja në një postim në "InstaStory". Vetëm disa muaj përpara overdozës, Demi ka publikuar këngën "Sober", duke zbuluar se vuante nga alkooli.

## Celine Dion merr vëmendjen me veshjen 6 000 dollarëshe



**C**eline Dion është kthyer në Paris ku ka treguar edhe trendët më të rinj të modës. Ikona e muzikës pop është parë në kryeqytetin francez me një palë pantallona të ngjitura me bluzë nga koleksioni i pranverës 2019 nga

marka e njohur "Chanel". Pantallonat e ngushta që këngëtarja e "My Heart Will Go On" kishte veshur kushtojnë 4 400 dollarë derisa ajo i kishte kombinuar me një rrip me logo të "Chanel"-it që kushton 1 650 dollarë.



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# 120 licenca për trajnerë të futbollit

Sekretari i Përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu, është shprehur shumë i kënaqur që është licencuar gjenerata e parë në Kosovë për trajnerë në bazë të sistemit të UEFA-s. "Ju jeni gjenerata e parë që licencoheni në Kosovë në bazë të sistemit të UEFA-s, të përcaktuar nga Jira Panel, që i cakton standardet e përgjithshme të sistemit të edukimit", ka thënë Salihu



PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - 120 licenca dhe certifikata për trajnerë janë ndarë nga Federata e Futbollit e Kosovës. Licencat janë ndarë për kurset e organizuara nga FFK-ja për licencën B për një grup, pastaj për dy grupe licenca C, për një grup licenca C për portierë si dhe certifikata "Grassroots Education Cours" për femra.

Të pranishëm në ceremoninë e ndarjes së këtyre licencave ishin nënkryetari i FFK-së, Agim Dibrani, sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu, drejtori teknik i FFK-së, Michael Ness, përfaqësuesja e Ambasadës së Gjermanisë, Zana Elshani, instruktori i DFB-së, Horst Krieste, menaxherja e Grassroots, Sanije Krasniqi dhe zyrtari i edukimit të trajnerëve, Lorik Fazlija. Sekretari i Përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu, ka theksuar se prioriteti kryesor i federatës është edukimi dhe licencimi i trajnerëve të futbollit. "Para 10 vjetëve kemi qenë të detyruar të bëjmë licencime të tilla në Federatën e Futbollit të Suedisë, pastaj edhe me Federatën Shqiptare të Futbollit, derisa individualisht trajnerët kanë bërë licencime edhe në federata të tjera. Personalisht licencën e kam marrë në Gjermani dhe ka qenë shumë e nevojshme që pikërisht

disiplinën dhe procesin e edukimit gjerman ta përfshijmë në sistemin tonë të edukimit, për çka i jemi falënderues DFB-së për bashkëpunim", ka thënë Salihu. "Si rezultat i këtij partneriteti,

kur e keni përfunduar, sigurisht se e shihni sa i rëndësishëm dhe sa i ka themelet e forta ky licencim", ka shtuar Salihu.

Ndërsa drejtori teknik Michael Ness ka rikujtuar se ardhjen e tij për punë



përveç procesit të edukimit, kemi marrë edhe një ekspert gjerman si drejtor teknik dhe kemi arritur që ta bëjmë licencimin e trajnerëve edhe nëpërmjet Federatës Gjermane të Futbollit. Mirëpo, ju jeni gjenerata e parë që licencoheni në Kosovë në bazë të sistemit të UEFA-s, të përcaktuar nga Jira Panel, që i cakton standardet e përgjithshme të sistemit të edukimit. E di që keni pasur një periudhë të vështirë, ngase ky kurs kërkon angazhim e përqendrim, por tash

në FFK e ka mundësuar Komiteti Olimpik i Gjermanisë, Qeveria gjermane dhe Departamenti i Punëve të Jashtme të Gjermanisë dhe se për këto tri institucione edukimi është prioriteti numër një. "Për herë të parë në Kosovë i kemi dy kurse pilote, por presim që shumë shpejt këto kurse të pranohen nga paneli i Jiras, pasi tashmë një gjë e tillë është vetëm formalitet. Besoj se deri në fund të vitit Licenca B do të njihet dhe do të shndërrohet 'UEFA Licence B'", ka thënë Ness.



## SHKURT

### Turku te Ballkani

Skuadra e Ballkanit ka vazhduar serinë e përforcimeve. Pas Durim Gashit, Arbër Hoxhës dhe Kushtrim Gashit, Edmond Turku është transferimi i katërt i skuadrës nga Suhareka në këtë afat kalimtar. "Mirë se vjen Edmon Turku!", thuhet në njoftimin e Ballkanit në "Facebook". Turku ka luajtur në shumë skuadra, kurse edicionin e fundit ishte pjesë e Dukagjinit të Klinës.

### Livoreka largohet nga Drita

Përparim Livoreka më nuk do të jetë pjesë e skuadrës së Dritës nga Gjilani. Konfirmimin për largim nga kjo skuadër e ka bërë me dije vetë futbollisti që ka luajtur edhe për Feronikelin, Lepencin dhe Hysin. "Nuk do të jem më pjesë e FC Drita. Sa isha pjesë e saj për dy vjet e gjysme kisha nderin ta bart një fanellë të një klubi të madh. Kisha kënaqësinë të përjetoj çaste të vështira, po ashtu edhe të mira, duke filluar nga kampioni i Kosovës, Superkupa e deri te majat më të larta të futbollit në Ligën e Kampionëve dhe Ligën e Evropës. Për këto të arritura të mëdha dua të falënderoj nga zemra kryesinë e klubit, në veçanti tifozët më të zjarrtë në trojet shqiptare, 'Intelektualët', për mbështetjen e palodhshme", ka thënë Livoreka.

### Xhaka, zëvendëskapiten i Baselit

Mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë, Taulant Xhaka, ka marrë një vlerësim nga trajneri Marcel Koller. Mesfushori shqiptar do të jetë zëvendëskapiten prej edicionit 2019-'20. Shtatshkurtri do të jetë pas kapitenit të ri të skuadrës Valentin Stocker. "Taulant Xhaka është një figurë identifikuese e Baselit", ka thënë trajneri Koller. Xhaka ka një jetë që luan për Baselin, pasi e ka nisur karrierën që te moshat dhe ka qëndruar larg vetëm një vit kur u huazua te Grassoppers në sezonin 2012-13.

### Zbulohen hollësitë e transferimit të Mavrajt në Greuther Furth

Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Mërgim Mavraj, është rikthyer te skuadra e Greuther Furthit. Futbollisti shqiptar për këtë skuadër ka luajtur edhe në periudhën 2011-2014. Kontrata e transferimit të Mavrajt nga Ingolstadt te Greuther Furthi nuk është bërë me dije, por "Further news" ka zbuluar se bëhet fjalë për një transferim që nuk e ka kaluar shifrën e 100 mijë eurove.

### Muriqi: Dy-tri ditët e ardhshme vendosi për të ardhmen

Reprezentuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, ka pasur një sezon fantastik duke realizuar 17 gola dhe ka bërë tetë asistime për bashkëlojtarët në të gjitha garat për Rizesporin. Kjo ka bërë që të interesohen shumë klube për 25-vjeçarin, duke përfshirë Fenerbahçen, Galatasarayn si dhe Lazion. "Ka ditë të tëra që po flitet për të ardhmen time, por nuk ka asgjë pa folur me presidentin e klubit tim. Ekzistojnë tri alternativa që presidenti m'i ka ofruar. Unë do t'i vlerësoj. Nëse shkoj, dua të përshëndetem me presidentin tim dhe të largohem ashtu siç duhet. Në 2-3 ditët e ardhshme gjithçka do të jetë e qartë", ka thënë sulmuesi për mediet turke.

## Bursistët mbështeten nga KOK-u

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Në kuadër të mbështetjes së Komitetit Olimpik të Kosovës për sportistët elitarë, dy bursistët e KOK-ut, atletët Musa Hajdari dhe Vijona Kryeziu, po e vijojnë kampin përgatitor në Zhablak të Malit të Zi. Bashkë me ta është edhe i riu Leon Thaqi, i cili përkrahet nga KOK-u para

pjesëmarrjes në Festivalin Olimpik Evropian Veror për të Rinj, "Baku 2019", që mbahet prej 21-27 korrik të këtij viti në kryeqytetin e Azerbajxhanit. "Përgatitjet janë duke shkuar shumë mirë. Jemi në lartësi mbidetare mbi 1 500 metra, diçka që është shumë e rëndësishme për atletë gjatë kësaj faze.

Përgatitjet janë duke shkuar shumë mirë. Presim të kemi performancë shumë më të lartë në aktivitetet që na presin", ka deklaruar Hajdari për "noc-kosovo.org". Me atletët është edhe trajneri i Kosovës, Zijadin Kryeziu. Kampi ka filluar më 17 qershor dhe do të zgjasë deri më 1 korrik.



## Karaqi përballet me medalistë botërorë dhe evropianë në Lojërat Evropiane

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Alvin Karaqi ka mësuar kundërshtarët për garat e karatesë në Lojërat e Dytë Evropiane "Minsk 2019". Karateisti i Kosovës, Alvin Karaqi, në kategorinë -84 kilogramë ndodhet në grupin B, ku bartës i grupit është kampioni i tanishëm botëror, Ivan Kvesiq nga Kroacia, njëherësh kampion edhe i Evropës për vitin e kaluar. Dy kundërshtarët e tjerë janë nënkampioni i tanishëm botëror, Valerii Chobotar i Ukrainës dhe Nikola Malovic i Malit të Zi, medalist i bronzit në evropianin e këtij viti të mbajtur në Guadalajara të Spanjës.

Garat e karatesë zhvillohen në grupe. Në kategorinë e Alvinin janë tetë garuesit më të mirë të Evropës, të ndarë në dy grupe. Garat zhvillohen secili me secilin, kurse në gjysmëfinale kalojnë dy të parët e grupit. "Është short shumë i vështirë. Janë të gjithë medalistë botërorë dhe evropianë. Luftën e parë e ka me Kvesiqin, që është bartës i grupit nga renditja e Minskut. Pres që Alvini të tregojë më të mirën", ka thënë trajnerja e tij Shqipe Zogiani për "noc-kosovo.org". Karateisti Karaqi nuk ka preferuar



të flasë, duke dashur ta ruajë gjithë fokusin te garat. Luftën e parë Alvini e zhvillon me kroatin Kvesiq, të cilin e kishte mposhtur në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018", por që ka edhe humbje ndaj tij. Të dytën e zhvillon me Chobotar të Ukrainës,

kurse të tretën me malazezin Maloviq. Karaqi në Lojërat Evropiane "Baku 2015" kishte zënë vendin e katërt, duke i ikur për pak medalja. Garat fillojnë sot (e shtunë), ndërsa kategoria e Alvinin fillon në orën 12:00 me kohën tonë lokale.

## Hamiltoni: Me Mercedesin ende kemi për të dhënë

LONDËR, 28 QERSHOR - Lewis Hamiltoni shprehet se, pavarësisht prej pesë titujve kampionë bote në Formula 1, ende nuk e ka arritur majën e karrierës. Piloti britanik i Mercedesit e ka nisur shkëlqyeshëm edhe sezonin 2019, duke u projektuar drejt titullit të gjashtë. Hamiltoni synon që brenda dy vjetëve ta arrijë rekordin e 91 fitoreve në Formula 1 që mbahet nga legjenda Michael Schumacher. Këtë fundjavë zhvillohet gara e Austrisë në Formula 1 dhe Hamiltoni nga 36 pikë avantazh karshi shokut të tij të skuadrës Valtteri Bottas. "Ndiej se kjo që kemi bërë është vetëm fillimi dhe më e mira ende nuk ka ardhur. Jam i sigurt se edhe këtu do të bëjmë një paraqitje të mirë. Mercedes? Ende nuk keni parë gjë nga Mercedesi dhe Hamiltoni", ka thënë Hamiltoni. "Jam në



formë të shkëlqyer fizike dhe psikologjike, gati për një tjetër garë. Punoj fort dhe shoh me optimizëm përpara, duke besuar

te makina dhe vetja. Gjithnjë punoj për t'u përmirësuar dhe do t'ia dal mbanë", ka shtuar Hamiltoni.

### SHKURT

#### Milani jashtë Ligës së Evropës

Milani zyrtarisht është tërhequr nga pjesëmarrja në Ligën e Evropës sezonin e ardhshëm pasi ka arritur marrëveshje me UEFA-n për Fair-Playin Financiar. Në një njoftim të Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv thuhet se palët janë marrë vesh që Milani të mos luajë në Evropë sezonin e ardhshëm për shkak të thyerjes së rregullave në sezonet e shkuara. Tani Milanin e zëvendëson Torino si ekipi i tretë italian në Ligën e Evropës, me Romën e kualifikuar drejtpërdrejt në fazën e grupeve.

#### 'L'Equipe': Griezmanni, në bisedime me Barçën

Antoine Griezmann ka ringjallur kontaktet me Barcelonën në lidhje me transferimin e tij te rivali nga La Liga. Ylli i Atletico Madrid ka vendosur të gjejë një ekip të ri gjatë këtij afati kalimtar të verës. E përditshmja sportive franceze "L'Equipe" raporton se reprezentuesi francez është sërish në kontakt me klubin katalan. Po ashtu, "L'Equipe" shkruan se marrëveshja për transferimin e Griezmannit te Barcelona mund të parashohë që mbrojtësi i krahut, Nelson Semedo, të kalojë në drejtim të kundërt te skuadra e Atletico Madridit.

#### Schalke emëron trajnerin e ri

Schalke 04 e ka prezantuar trajnerin e ri David Wagner. Nën drejtimin e tij skuadra do të ketë ndryshime rrënjësore dhe, krahas blerjeve të parashikuara për çdo repart, do të ketë edhe largime. Drejtori sportiv, Schneider, u tregua i qartë teksa përmendi emrat e atyre që trajneri nuk i shikon në planet e tij. Behet fjalë për mbrojtësin Hamza Mendyl dhe mesfushorët Konoplyanka e Bentaleb. Nga shitja e tyre klubi synon të arkëtojë rreth 30 milionë euro që më pas do të investohen për afrimet e reja.

#### Hummelsi prezantohet te Dortmundi

Mats Hummels është prezantuar si lojtar i ri i Borussia Dortmundit. Marrëveshja në mes të Bayernit dhe Dortmundit për mbrojtësin gjerman ishte bërë publike dy javë më parë, por sot erdhi prezantimi zyrtar. Mbrojtësi në vitin 2016 ishte larguar nga "Signal Iduna Park", kurse tash ka nënshkruar kontratë trevjeçare me Dortmundin.

#### PSG-ja nënshkruan superkontratë me "Niken"

PSG-ja ka nënshkruar kontratën e verës. Kampionët e Francës kanë arritur një marrëveshje fantastike me firmën "Nike" deri në vitin 2032. Plot 80 milionë euro në vit do të përfitojë PSG-ja nga prodhuesi gjigant amerikan. Deri në vitin 2022 është aktive kontrata e vjetër me 25 milionë euro fitime në vit, ndërsa më pas fitimet do të shumëfishohen. Ky pajtim ka të bëjë edhe me ekipin e femrave dhe atë të hendbollit, ndërsa PSG-ja e cilësoi si marrëveshja më e madhe e sponsorizimit në historinë e klubit. Bisedimet u udhëhoqën nga presidenti Naser Al-Khelaifi dhe një marrëveshje e tillë e fut PSG-në në pesë klubet me kontratat më të mëdha të nënshkruara me sponsorët sportivë.



<b>EPOKA ERE</b>						<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO (shqip.)	SHUMË, TEJ MASE	PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT (pashq.)	UNIVERSITY LANCASTER OHIO	TINARI	<b>EPOKA ERE</b>	SHTËPIZA E NDËRTUAR ME DËRRASA	ZANORE	GUR I ÇMUAR ME NGJYRË TË KALTËR OSE TË GJELBËR	PIANISTJA LULE .....	KËNGËTARJA .... MUÇAJ
						LËNG I TRASHË VESHTULLOR QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTAËS	○					PELLG I HAPËT PËR TË GRUMBULLU-AR UJË BASHKËT.					
						KËNGËTARJA ..... EMINI	○						PËRGJIGJE NË TELEFON E GDHENDA				
						SHKËMB I PËRBËRË PREJ RËRE	○					ARBITËR BEREQET					
						LETRARI ASLLANI	○			METODË STUDIMI PËRSHTATJE (sh.shq.)							
						VETIA THELBËSORE E QENIEVE TË GJALLA	○				FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË SHITET FEDERAL NË SHBA						QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE
						KALË SHALE	○		THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (sh.shq.) "KENIA"					GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.)	ZANORE GAZ QË SHPËRTHEN KUR DIKUSH TALLET ME DIKË		
						BASHKËT.	○	PJESË E FORTË E BUKËS "RISANI"					LLOJ BIME ME TË CILAT BEJMË PILAF				
<b>EPOKA ERE</b>	LOJ PËLHURË E TRASHË SI STOF	QË I MOHON NORMAT E MORALIT	AKTORJA E FAMSHME ANDERSON		VESHJE E SIPËRME PREJ SHAJAKU LLOJ LOJE FATI	MURG I VETMUAR AMPER, RENUIM	○						DALLGA SHOK				
DAMARI I GJAKUT							○		OLIVIA ZUMWALT INSTITUTE DEFENSE ANALYSES			TENISTI ..... SAFIN BASHKËT.					
DILETANTI							○	IDHULLI KËNGËTARJA LIBOHOVA					"IRLANDA" KËNGËTARJA GANIMETE				GABZHERRI, GURMAZI
BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE QË PËRDORËT SI USHQIM								FUTBOLLISTI ..... XHEKO FUTBOLLISTI SENEGALEZ ARMAND ..... (QPR)				GJAKATAR KUVENDI I KOSOVËS					
AKTORJA ..... PAPAS						KËRCELL I BIMËS SË MISRIT ZANORE							SHKRONJË GREKE NDODHEM RASTËSISHT NË NJË VEND				
DHUROJ DIÇKA				RANISHTJA PËSHTJELLIM (shq.)					ZANORE I AFRUAR		GRYKË E VULLKANIT LECKA PËR ARNIM						
HOVI, VRULLI						KËNGËTARJA AMERIKANE ..... BAKER BASHKËT.						ANGOLA, ZAMBIA ZANORE			TITAN VAJZA E DJALIT A E VAJZËS		
<b>EPOKA ERE</b>	SHKRIMTARI ..... HAZIRI	I PARI I MURGJVE NË NJË ABACI (pashq.)	BASHKËT. KAFSHË SHTËPIAKE ME TRUP E ME QAFË TË TRASHË		KLUB FUTBOLLI NË HOLLANDË RADIUM, ZET					HUMORISTI ..... THAQI PJESË E ILIRISË							BASHKËT. SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË (bised.)
RADIOLOK-ATOR					BIMË E CILA PËRDORËT PËR USHQIM RAPSODI BERISHA (shq.)							BASHKËT. ROMANCIERI GJERMAN ERIK MARIA		KËNGËTARJA JONË '... MAMA'			
LIBËR FILLESTAR								KAMPIONI MËSYMJE						ISH FUBOLLISTI BRAZILIAN ... GASPAL (ARSENAL) VEZAK			
ÇMENDURI; BUDALLA-LLËK						BABAI AMERICAN TEATRE ORGAN SOCIETY					E BITISA I NDESH						VEZË PESHKU (shq.)
ARTIOLA TOSKA			BASHKËT. BUILDING INFORMATION MODELING		REGJISTRIM NË FATURË I ÇMIMIT TË NJË MALLI SIENA								KAPI DIÇKA TE PJESA E SIPËRME NË NJË GOZHDE TEXAS EDUCATION AGENCY				
BASHKËT.		BESËLIDHËS RAMADAN AVDIU									KOB BEN AFLEK				ERNEST KOLIQI AFËRDITA DRESHAJ		
KLUB FUTBOLLI NË GREQI					BASHKË, ME TOTENHAM				SHTRATI QË PËRDORËT PËR TË MBARTUR TË SËMURËT BASHKËT.							BASHKËT. ZANORE	
PËSHPËRIT DIKUJT FJALË MAGJIKE								MBULESA QË E VË DIKUSH NË FYTYRË PËR TË MOS U NJOHUR NGA TË TJERËT						DËSHIROJ			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
 Qeveria - Vlada - Government  
 MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
 MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
 MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT  
 Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Ruralni Razvoj/ The Agriculture Development Agency

## Njoftim për fermerët dhe ekonomitë bujqësore

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural njofton të gjithë fermerët dhe ekonomitë bujqësore të Republikës së Kosovës se afati për aplikim për pagesa direkte për kulturat bujqësore dhe projektet e zhvillimit rural/grantet investive për vitin 2019 për masën 101, për masën 103, për masën 302, për masën e ujitjes së tokave bujqësore dhe për masën 303 është zgjatur deri më 12 korrik 2019.

Kjo zgjatje e periudhës për aplikim po bëhet për shkak të kërkesave të shumta të palëve të interesuara dhe Drejtorive Komunale për Bujqësi, duke iu mundësuar në këtë mënyrë aplikimin të gjithë fermerëve dhe ekonomive bujqësore, që kanë mbetur pa aplikuar deri më tani. Procedurat e aplikimit dhe dokumentacioni mbetet i njëjtë.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
 Qeveria - Vlada - Government  
 MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
 MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
 MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT  
 Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Ruralni Razvoj/ The Agriculture Development Agency

## Obaveštenje za farmere

Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja obavestava sve farmere Kosova da je rok za podnošenje zahteva za direktna plaćanja za poljoprivredne kulture i investicione grantove za 2019. za meru 101, za meru 103, za meru 302, za meru navodnjavanja poljoprivrednog zemljišta i za meru 303 produžen do 12. jula 2019. godine.

Produženje perioda za podnošenje zahteva je zbog brojnih zahteva zainteresovanih strana i Opštinskih Direkcija za poljoprivredu, čime se omogućava apliciranje svim farmerima i poljoprivrednim ekonomijama, koje do sada nisu mogli da apliciraju.

Procedure i dokumentacija za apliciranje ostaju iste.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë  
 Ministarstvo za Inovacije i Preduzetništvo/ Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme/ Department za Financije i Opste Sluzbe Department of Finances and General Services

Data: /2019  
 Ref: /2019

Divizioni i Burimeve Njerëzore

### Njoftim për Anulimin e Konkursit

Anulohet konkursi i publikuar në web faqën e MIN dhe gazetën ditore "Epoka e Re", me datën 30/05 /2019, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Ndërmarrësisë me nr.APF0005411 të konkursit . Anulimi i konkursit bëhet për arsye të numrit të pamjaftueshëm të kandidatëve për të iu nënshtruar testimit me shkrim.

Divizioni i Burimeve Njerëzore

### Obaveštenje o poništavanju konkursa

Poništava se konkurs objavljen na web stranici MIP i dnevnim novinama „Epoka e Re“, dana 30.05.2013. godine, za poziciju **Rukovodioca Divizije za preduzetništvo** sa brojem konkursa APF0005411. Konkurs se poništava zbog nedovoljnog broja kandidata za pismeno testiranje.

Divizija za ljudske resurse



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health  
 Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës  
 Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova- Hospital and University Clinical Service of Kosovo  
 Spitali i Përgjithshëm, General Hospital, Opšta Bolnica, Genel Hastane  
 "Prim. Dr. DAUT MUSTAFA" - Prizren

Nr. 8/28  
 Datë: 28.06.2019  
 Lënda: Anulim Konkursi

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik, Neni 6.

Anulohet

konkursi publik nr. 8/26, i datës 07.06.2019.

Drejtor i Administratës  
 M. Sc. i Juridikut: **Mehinda Colaku**



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/giejpuneshpeite](http://www.facebook.com/giejpuneshpeite)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government  
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health  
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës



Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës – Univerziteti Stomatološki Klinički Centar Kosova –  
University Dentistry Clinical Center of Kosovo

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitive të nenit 4. dhe neni 5 të Udhëzimit(MPMS)Nr. 07/2017 Administrativ për Rregullimin e Procedurave të Konkursit për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, nenit 15 dhe 21 të Statutit, Rregullores mbi Organizimin, Sistematizimin e vendeve të punës dhe Aproximit të kërkesës nr 214, nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK –së, Qendra Klinike Stomatologjike Universitare shpall :

### Konkurs Për plotësimin e vendit të lira të punës

**Titulli i punës:** Punëtor/e në Kartotekë ( dy pozita) 004/2019-QKSUK; Dt: 29.06.2019  
**Njësia:** Departamenti i Administratës Qendrore  
**Orari i punës:** Normë e plotë  
**Koeficienti:** H-65 / 4.80  
**Nëpunësi mbikëqyrës:** Kryeshefi i DAQ-it  
**Kohëzgjatja e Kontratës:** Me kohë të pacaktuar

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

Kryen punët administrative të klinikës përkatëse.  
Mbajtja e evidencës në mënyrë elektronike dhe i futë të dhënat në SISH të QKSUK-së,  
Jep kartonët pacientëve për trajtim mjekësor, dhe të njëjtit i sistemon në kartotekë.  
Përpunon shënimet statistikore ditore, javore, dhe mujore, dhe të njëjtat i paraqet udhëheqësit.  
Është përgjegjës për azhuritë në punë.  
Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.  
**Kualifikimi:** Shkolla e mesme e lartë,

**Përvoja:** 1 vjet përvojë punë.


#### Aftësitë:

Themelimi i marrëdhënieve të mira ndër-personale dhe mbajtja e kontakteve me personat vendim marrës në Klinikë.  
Njohja e gjuhëve zyrtare, në përdorim.  
Aftësitë e mira të komunikimit.  
Gatishmëria për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe me pak mbikëqyrje.  
Njohja e mire e punës me kompjuter (Microsoft Word dhe Excel).  
Trajnimet e ndryshme nga lëmia përkatëse paraqesin përparësi.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

**Procedurat e konkurimit:** Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Data e mbylljes së konkursit: **15 ditë** kalendrike nga dita e shpalljes.  
Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e personelit të QKSUK-së.  
Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/ VLADA KOSOVA  
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

28.06.2019

### NJOFTIM PER ANULIMIN E KONKURSIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbështetur në Procedurat e Rekrutimit, njofton për anulimin e konkursit të shpallur me 24.05.2019, Referenca 28/2019, për pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor, bazuar në Vendimin e nxjerrur nga KPSHC Nr. 2647/2019, të datës 28.06.2019

### OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, na osnovu procedure zaposljavanja, obavestava o anuliraju konkursa dana 24.05.2019, o poziciju Visi pravni sluzbenik, Preporuka 28/2019, bazirajući se se na Odluku SCCS, Br.2647/2019, datuma 28.06.2019.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government  
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health  
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës



Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës – Univerziteti Stomatološki Klinički Centar Kosova –  
University Dentistry Clinical Center of Kosovo

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br. 03 / L-212, odredbe člana 4. i člana 5. Uputstva (MRSZ) br. 07/2017 Upravni postupak za regulisanje javnih ugovora za utvrđivanje odnosa sa javnošću, čl. 15. i 21. Statuta, Pravilnik o organizaciji, sistematizaciji radnih mjesta i odobrenje br. 214, od strane Generalnog Direktora UBKSK, Univerziteti Klinički Centar za Stomatologiju objavljuje:

### Konkurs Za dopunu slobodni radni mjesta

**Radno mesto:** Radnik na kartoteci (dve pozicije) Br. Ref. 004 / 2019- USKCK Dt: 29.06.2019  
**Jediniца:** Departman Centralne Administracije  
**Radno vreme:** Puna norma  
**Koeficijent:** H-65 / 4.80  
**Nadzorni službenik:** Nadzorni Šef DCA  
**Trajanje ugovora:** Neodređeno vreme

#### Dužnosti i odgovornosti:

Obavlja administrativne poslove vezane za kliniku.  
Vodenje evidencija u elektronskom obliku i unosi podatke u zdravstveni informativni system.  
Daje kartone pacijentima za lečenje, a istestavlja u kartoteci.  
Radi statističke dnevne, nedeljne, i mesečne podatke i dostavlja nadzorniku.  
Odgovoran za spremnost na poslu.  
Obavlja i druge poslove po naredjenju nadzornika.

**Kualifikacija:** Viša Srednja škola

**Iskustvo:** 1 godina radnog iskustva.

#### Sposobnost:

Uspostavljanje dobri međuljudskih kontakata sa licima koja obavljaju donošenje odluka u USKCK.  
Znanje službenih jezika u upotrebi.  
Dobre sposobnosti komunikacije.  
Spremnost da rade samostalno i sa malo nadzora.  
Dobro poznavanje rad sa kompjuterom (Microsoft Word i Excel).  
Stručno obrazovan relevantnoj oblasti predstavlja prioritet.

**Uslovi učesća u zapošljavanju:** mogu da se prijave svi građani Republike Kosova odraslih u koji imaju punu pravnu sposobnost, koji su završili odgovarajuće obrazovanje i profesionalne sposobnosti da obavljaju svoje dužnosti.

**Uslovi konkursa:** Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.  
Rok Konkursiranja 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja,  
Podnošenje prijave: Prijave se primaju i dostavljaju u kancelariju Personalne službe USKCK.

Aplikacija posle isteka konkursnog roka neće se razmotriti.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatr-it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania N.T. "Rimida" Llapnasellë, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e objektit hotelierik B+S+P+3 në vendin e quajtur "Kod Izvor" në Vërbeshtinë komuna e Shtërpçës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 25.07.2019 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Pine" rruga për Brezovicë, do të organizohet debat publik nga kompania N.T. "Rimida" Llapnasellë, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e objektit hotelierik B+S+P+3 në vendin e quajtur "Kod Izvor" në Vërbeshti në komuna e Shtërpçës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Kafe - Piceria "Oxhaku" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit 70384927 dhe NF " 600077871 Prizren

► "Baron - A " ShPK. Me numer biznesi 810983569 ne Prizren ben likuidimin e mallit duke filluar me daten 01.07 .2019 Prizren

► Fatmir Sylejmani shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme " Hoxhë Kadri Prishtina" Prishtinë.

► Besnik Xhemajlaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Anton Çetta" Skenderaj, drejtimi Ekonomi dhe Financa.

► Mimoza Rexhepi nga Prishtina shpall të pavlefshme tri dëftesat, certifikatën dhe Diplomën e lëshuar nga shkolla "Hoxhë Kadri Prishtina" në Prishtinë.

► D.P. "BURGER SHOP" me seli në Prishtinë, shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit me numër: 71120481 dhe numër fiskal: 601197248.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

# RESTAURANT

# SWISS

# TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA  
Since 1899